CREDINS bank

RAPORTI VJETOR 2018

1
MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

2
DIVIZIONI I RISKUT, OPERACIONAL, FINANCIAR DHE I BIZNESIT

3
BURIMET NJERËZORE

4
PËRGJEGJËSIA SOCIALE

5
RAPORTI I AUDITORËVE

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

MALTIN KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

CREDINS PËRMBUSHI
ME SUKSES REALIZIMIN E PLOTË TË
OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Viti 2018 është finalizuar me një performancë të kënaqshme për Credins Bank në të gjithë treguesit kryesorë financiarë. Credins përmbushi me sukses realizimin e plotë të objektivave strategjike të planit të zhvillimit 3-vjeçar të bankës, duke konsoliduar pozicionin e vet në treg si banka e dytë më e madhe në kredidhënie dhe e treta në depozita. Portofoli i kredisë u rrit në mënyrë të kujdesshme duke mbështetur klientët ekzistues dhe ata të rinj të cilët prezantuan plane investimi të suksesshme, gjithmonë duke respektuar parametrat e riskut për të gjithë sektorët ku banka ka prioritetet përkatëse për t'u zhvilluar. Fokusi ynë ishte dhe mbetet modernizimi i vazhdueshëm i infrastrukturës teknologjike dhe sjellja e risive për të përmbushur dhe paraprirë kërkesat gjithmonë në rritje dhe inovative të klientëve të bankës. Optimizimi i strukturës së degëve nëpërmjet finalizimit të sukseshëm të projektit të trajnimit të stafit për rritje të aftësisë së shitjes (SFE), dha rezultate mjaft pozitive në drejtim të rritjes së shitjeve në degë, ndërveprimit aktiv me klientët dhe shërbimit të kënaqshëm, të cilat kanë ndikuar në përzgjedhjen e Credins si banka numër 1 për nevojat e tyre financiare.

Situata ekonomike në vend dhe ajo globale. Si ka reaguar Credins.

Pavarësisht sfidave të vazhdueshme të vitit 2018 të lidhura me situatën e përgjithshme ekonomike globale, ndryshimet në rritje të kërkesës rregullatore, luhatjet e ndjeshme të kursit të këmbimit, proceset e konsolidimit të sistemit bankar, Credins arriti të ruajë me sukses një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit, kredisë me probleme, rritje të të ardhurave dhe konsolidim të kënaqshëm të marrëdhënieve me klientët. Credins investoi më shumë në drejtim të transformimit dhe thjeshtëzimit të platformës digjitale 'Credins Online', për t'u ardhur më afër klientëve me funksionalitete të reja dhe për t'ua thjeshtëzuar përdorimin kudo ku ndodhen.

Ecuria sipas departamenteve kryesore

Gjatë 2018, pati një rritje të ndjeshme të portofolit të depozitave bankare, tregues ky i marrëdhënieve të besueshmërisë Bankë – Klientë. Portofoli i kredisë vazhdoi të rritej në përputhje me strategjinë e bankës për një balancim midis segmentit individë dhe biznese. Credins Bank u fokusua në mbështetjen e agrobiznesit, duke i ardhur në ndihmë fermerëve, jo vetëm me financime por dhe me ekspertizë. Rritje të ndjeshme pati dhe volumi total i pagesave të brendshme dhe atyre të jashtme si dhe u rrit ndjeshëm numri i kartave të reja e përdorimi i tyre, duke ndikuar në uljen e 'cash' –it në ekonomi, edhe pse kjo mbetet ende një sfidë për ekonominë shqiptare. Që nga 1 Janari 2018, banka aplikoi standartin e ri 'IFRS9' për modelin e biznesit, vlerësimin dhe klasifikimin e aseteve me risk.

Në Korrik 2018, Credins ishte një nga bankat e përgjedhura në projektin e Bankës Botërore për ankandin e obligacionit referencë 5 vjeçare si dhe mjaft e angazhuar në zhvillimin e tregtimit të letrave me vlerë në tregun sekondar duke mbështetur klientët me alternativë investimesh. Gjatë kësaj periudhe Credins Bank, si një nga pesë zhvilluesit e tregut, ka dhënë kontributin e saj maksimal në rritjen e volumit të tregtimit në tregun sekondar, duke pasur si qëllim rritjen e bazës së investitorëve. Kultura e korporatës që ne kemi krijuar brenda institucionit tonë reflekton vlerësimin maksimal që Credins ka për asetin më të rendësishëm; kapitalin njerëzor. Credins spikat për investime të vazhdueshme në trajnime dhe rritjen profesionale të stafeve të rinj, duke ndihmuar zhvillimin e tyre në karrierë, si forca shtytëse për një shërbim sa më profesional ndaj klientëve. Ambiciet tona reflektohen në një proces të pandalshëm punësimi të të rinjve të talentuar përgjatë 2018, kombinuar me një balancë mjaft të mirë menaxheriale mes gjinive. Credins vazhdon me prioritet maksimal kontributin e tij në fushën e përgjegjësisë sociale ku nëpërmjet donacioneve dhe sponsorizimeve të ndryshme, synon të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, infrastrukturës, artit, kulturës, arsimit etj. Iniciativat e vazhdueshme të ndërmarra vazhdojnë ta rendisin Credins Bank si një nga mbështetësit kryesor të zhvillimit të shoqërisë.
Ne do të vazhdojmë të ndjekim me prioritet Planin Strategjik 2019-2021 të zhvillimit ku përcaktohen drejtimet strategjike që do të udhëheqin veprimtarinë e bankës në të ardhmen. Kjo strategji shpreh ambiciet tona për t'u zhvilluar dhe për të përparuar sipas standarteve më të mira ndërkombëtare.
Prioritetet kryesore të identifikuara janë:

I. Zhvillimet teknologjike nëpërmjet transformimeve të vazhdueshme të sistemeve dhe infrastrukturës së IT-së për të sjellë produkte inovative në përshtatje me sjelljet e reja të konsumatorëve. "Dega Lëvizëse" do jetë një risi për tregun shqiptar që do të iniciojë shërbimin e saj lëvizës në çdo skaj të vendit në 2019, duke mbështetur klientët agro me prezencën e vet kudo dhe duke ofruar shërbimet bankare edhe në zonat rurale ku mbulimi me banka është relativisht i ulët.

II. Zhvillimi strategjik i partneriteteve me partnerë ndërkombëtarë për të sjellë lehtësira për bizneset e vogla dhe të mesme duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, siç është projekti 'COSME' që pritet të finalizohet përgjatë 2019.

III. Zhvillimi dhe menaxhimi i Kapitalit Njerëzor si forca kryesore e arritjes së çdo rezultati të kënaqshëm.

IV. Zgjerimi i bankës në Kosovë është një nga objektivat dhe sfidat e Credins, projekt i cili është në faza të avancuara dhe pritet të finalizohet përgjatë 2019.

Prioritetet e përcaktuara të cilat kontribojnë në përmbushjen me sukses të iniciativave afatshkurtër dhe afatmesme janë mjaft thelbësore për rolin kyç që Credins Bank ka në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, përmbushjen e kërkesave të klientëve dhe stafit për një mirëqënie gjithmonë në rritje. Si dhe të aksionerëve tanë të cilët na kanë mbështetur me besim të plotë në rrugëtimin tonë të sukseshëm.

KËSHILLI DREJTUES

SAJMIR SALLAKU
KRYETAR

JONAS HASSELROT
ANËTAR

CLIVE MOODY
ZV. KRYETAR

RAIMONDA DUKA
ANËTARE

MONIKA MILO
ANËTARE

ELTON TORO
ANËTAR

MALTIN KORKUTI
ANËTAR

KARTA BANKARE VISA DHE MASTERCARD

PËR TË QENË SA MË PRANË KLIENTIT ME ZGJIDHJET DHE ALTERNATIVAT MË TË FUNDIT BASHKËKOHORE.

DIVIZIONI I RISKUT

Banka Credins i kushton një vëmendje të veçantë procesit të manaxhimit të riskut, jo vetëm si aspekt dhe kërkesë rregullatore, por si frymë e përgjithshme që udhëheq veprimtarinë e përditshme bankare.

Për manaxhimin e riskut banka ka struktura të dedikuara të cilat kryejnë monitorimin e riskut në veprimtarinë e përditshme bankare. Struktura kryesore për manaxhimin e riskut është Divizioni i Administrimit të Riskut, i cili është përgjegjës për të identifikuar, matur, monitoruar, parandaluar dhe raportuar aktivitetin e lidhur me manaxhimin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor. Gjatë vitit 2018, të gjitha strukturat e Riskut si dhe Komitetet e Riskut, Kontrollit, ALCO dhe deri te Këshilli Drejtues kanë siguruar një menaxhim të kujdesshëm në përputhje me kuadrin rregullator dhe legjislacionin përkatës, përfshirë dhe atë kundër aktiviteteve për pastrimin e parave.

Banka ndjek një politikë në lidhje me 'oreksin' për risk, në përputhje edhe me nevojat rregullatore, në lidhje me vlerësimin dhe kontrollin e një sërë rreziqesh kryesore, si risku i kredisë, i përqëndrimit të kredisë, riskut qeveritar, riskut të kursit të këmbimit, etj. Në këtë dokument caktohen disa kufij dhe jepet toleranca e bankës kundrejt ekspozimeve në risk për investimet dhe aktivitetet e saj.

Viti 2018 ishte nje vit me luhatje të normave të interesit, ku ato për monedhën vendase ndoqën një trajektore në rënie dhe ato të monedhave të huaja, veçanërisht në euro, ishin në nivelet më të ulëta historike. Kjo paraqiti një sfidë për administrimin e investimeve dhe ne zbutjen e ekspozimeve në risk prej tyre, duke synuar ruajtjen e një niveli të përshtatshëm të rendimentit të investimeve dhe të të ardhurave nga interesat. Divizioni i Riskut, në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit, ka mundësuar balancimin mes ruajtjes së kufijve të ekspozimit në risk dhe maksimizimit të rendimentit të investimeve të tyre. Ndërkohë viti 2018 ishte edhe një provë për krijimin dhe zhvillimin e tregut dytësor të titujve të qeverisë nëpërmjet emetimeve dhe kuotimeve ditore për çmimet e titujve referencë, ku Credins Bank është një nga zhvilluesit e tregut. Kjo përforcoi angazhimin dhe kapacitetet e njësisë së riskut në monitorimin dhe matjen e ekspozimeve ndaj riskut të normave të interesit dhe parashikimet për ecurinë e 'yeld'-it të titujve në vijim.

Njëkohësisht në diversifikimin e investimeve gjatë viteve të fundit divizioni i riskut është fokusuar në gjetjen dhe monitorimin e investimeve me ekspozim të ulët në risk, të shoqëruar edhe me forma të mbrojtjes ndaj riskut nëpërmjet derivateve, si një risi në tregun vendas.

BANKA CREDINS I KUSHTON NJË VËMENDJE TË VEÇANTË PROCESIT TË MANAXHIMIT TË RISKUT, JO VETËM SI ASPEKT DHE KËRKESË RREGULLATORE, POR SI FRYMË E PËRGJITHSHME QË UDHËHEQ VEPRIMTARINË E PËRDITSHME BANKARE.

Në bazë të monitorimit të vazhduar të riskut janë respektuar të gjithë objektivat dhe kufijtë për risqet e tregut, veçanërisht për riskun e likuiditetit, gjithmonë duke përmbushur nevojat e bankës në çdo moment për likuiditet në çdo monedhë. Divizioni i riskut, pavarësisht të gjitha zhvillimeve dhe sfidave që ka hasur tregu ndërbankar dhe ai i titujve gjatë vitit, në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit, ka arritur të këtë një qasje të kujdesshme për administrimin e likuiditeteve, dhe duke ruajtur një performancë të mirë në një mjedis sfidues për sa i takon normave të interesit, të cilat kanë qenë në rënie të vazhdueshme.

Banka në përputhje me rregullorët dhe me standardet ndërkombëtare ka aplikuar rishikimet më të fundit të 'Basel 3' në lidhje me matjen dhe monitorimin e riskut të likuiditetit dhe të normës së interesit.

Fokusi kryesor i administrimit të riskut gjatë vitit ka qenë në vlerësimin, matjen dhe diversifikimin e nevojës për kapital në bazë të klasave të aseteve të veçanta dhe ekspozimit të tyre në risk. Njëkohësisht banka ka kryer edhe një vlerësim të nevojës së brendshme për kapital nëpërmjet një procesi të detajuar duke përfshirë një sërë risqesh të veçanta, që janë jashtë kuadrit rregullator për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, si risku i përqendrimit të kreditimit, riskut të vendit, riskut të mbetur të tregut, riskut reputacional dhe strategjik, shoqëruar me skenare stresi për secilin prej risqeve kryesore. Kjo i jep bankës mundësi për të pasur një vlerësim më të gjerë të ekspozimit në risk, jo vetëm të aseteve në dispozicion, por të gjithë aktivitetit dhe operacioneve që kryen në përditshmërinë e saj. Në bazë të këtyre vlerësimeve arrin të japë një nevojë të mundshme shtesë për kapital për të mbuluar ekspozimin ndaj gjithë risqeve dhe të kryejë parashikime dhe të buxhetojë më mirë burimet dhe fondet e rritjes se kapitalit të vet.

Që nga 1 janari 2018, banka ka aplikuar standardin e ri IFRS9 për modelin e biznesit, vlerësimin dhe klasifikimin e aseteve me risk nëpërmjet disa shkallëve, llogaritjen e humbjeve të kreditimit sipas jetëgjatësisë së ekspozimeve të klasifikuara për shkallën e dytë në risk. Janë kryer nga Divizioni i Riskut vlerësimet fillestare të ndikimit të kalimit drejt standardit të ri për llogaritjet e vlerës së provigjonimeve me futjen në fuqi në fillim të vitit dhe njëkohësisht në vazhdimin e llogaritjeve përgjatë gjithë vitit 2018.

Gjatë 2018, Credins Bank ka synuar të ketë një balancim mes përthithjes së fondeve në monedha të ndryshme dhe në investimin e tyre nëpërmjet dhënies së huave në këto monedha. Njëkohësisht për bankën ka qenë e rëndësishme zbutja e ekspozimit ndaj riskut indirekt të kredisë, si pasojë e kursit të këmbimit, edhe duke rekomanduar marrjen e huave nga klientët në monedhë të njëjtë me të ardhurat e tyre, ose në raste të tjera në konvertimin e huave ekzistuese në Euro drejt monedhës vendase. Kjo gjë shfaqet në një nivel më të ulët të Credins Bank ndaj këtij ekspozimi në raport me të dhënat e publikuara si për kreditë dhe për depozitat që ka gjithë sistemi bankar vendas. Në këto kushte vlerësohen të rëndësishme masat përtej sistemit bankar, në sistemin ekonomik të vendit, ku parësore është pjesa e informalitetit dhe nxitja e përdorimit të monedhës vendase në pjesën dërrmuese të transaksioneve brenda vendit.

Fryma e përgjithshme e indeksimit të gati gjithë mallrave të tregtuara me pakicë në monedhën europiane, veçanërisht ato direkte nga importi, drejt një indeksimi vetëm në monedhën vendase, do të japë një ndihmesë të rëndësishme në kërkesën e lartë për euro që ekziston tashmë në tregun shqiptar.

Njëkohësisht masat për informimin e klientelës së bankave rreth risqeve të ekspozimit nga luhatjet e kursit të këmbimit janë një ndihmesë në ndërgjegjësimin dhe udhëzimin drejt një investimi më të sigurt. Kjo masë është ndjekur nga Credins Bank si pjesë e informimit dhe transparencës ndaj publikut, duke i parashtruar në formë të detajuar në marrëveshjet me klientët, dhe në mënyrë të ndjeshme drejtpërsëdrejti në dialogun e përditshëm në këshillimin që ofron banka për gjithë klientët e saj.

DIVIZIONI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

RRITJA NETO E DEPOZITAVE ËSHTË 182% E BUXHETIT NDËRSA SË BASHKU ME OBLIGACIONET SHKON RRETH 200% E REALIZIMIT TË PRITSHËM.



DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË SHITJEVE NË DEGË

Viti 2018 shënoi vitin e dytë të sukseshëm për përmirësimin e procesit shitës në degë, pas implementimit të projektit të rëndësishëm mbi "Rritjen e efiçencës së forcës shitëse". Nxitja, suporti, kontrolli dhe vlerësimi janë tashmë fjalët kyçe të procesit shitës në çdo degë të bankës. Produktiviteti i degëve i cili matet si numri i produkteve të shitura për staf shitës në degë, ka shënuar 17% rritje edhe përgjatë vitit 2018, në nivele të përafërta me vitin e kaluar. Produktet në fokus kanë vazhduar të jenë depozitat dhe obligacionet e bankës, të cilat së bashku kanë tejkaluar buxhetimin për këto produkte. Vetëm rritja neto e depozitave është 182% e buxhetit ndërsa së bashku me obligacionet shkojnë në rreth 200% të realizimit të pritshëm. Portofoli i kredisë i gjeneruar nga rrjeti i degëve ka vazhduar rritjen në segmentin 'Retail' sidomos në kreditë konsumatore për segmentin 'Individë' dhe kreditë për investime në segmentin 'Mikrokredi'. Në kuadër të projektit të qeverisë "100 fshatrat" banka i ka dhënë fokus edhe produktit të kredisë 'Agro' duke implementuar disa marrëveshje me fondacione jo fitimprurëse që mbështesin zhvillimin e agrobiznesit ashtu si edhe me sjelljen e një risie në treg nëpërmjet "Degës Lëvizëse" e cila ka për qëllim të jetë pranë fermerit edhe në zonat më të thella të Shqipërisë. Gjatë 2018, objektivi për rritjen e tepricës së portofolit 'leasing' u arrit në masën 125%, duke rritur disbursimet me rreth 20% krahasuar me një vit më parë, duke u shoqëruar me rritje të 'market share' me 6%.

Këtë vit rezulton një rritje e komisioneve me rreth 7% krahasuar me vitin e kaluar, rritje e cila është vërtetuar në gjithë rajonet e bankës. Këto të ardhura rezultojnë nga komisionet e gjeneruara nga POS, Karta, transferta dhe rritje e transaksioneve 'cash'.

Gjatë vitit 2019 prioritete strategjike për rrjetin e degëve mbeten: ruajtja e avantazhit konkurues të cilësisë së lartë të shërbimit ndaj klientelës, vazhdimi i automatizimit të proceseve manuale në degë – në bashkëpunim me Divizionin Operacional, i cili vitin e kaluar shënoi përmirësim të ndjeshëm si edhe vazhdimi i rritjes së shitjes së kryqëzuar në degë si përsa i përket produkteve tona ashtu edhe produkteve të kompanive partnere si 'Fondi i pensionit' dhe 'Credins Invest' etj. Një objektiv i rëndësishëm strategjik afatmesëm është konvertimi i pozicionit shitës në degë në Menaxher Klienti i cili do të aftësohet më tej për shitjen dhe procesimin e të gjitha produkteve që ofron banka tek klienti i tij duke i shërbyer atij me një cilësi dhe produktivitet të shtuar.

DEPARTAMENTI I PROJEKTEVE

Gjatë vitit 2018, aktiviteti i Departamentit të Projekteve ka qënë i fokusuar në mbështetje të iniciativave strategjike të ndërmarra nga Banka.

- Projekti 'Credins Bank Kosova', ishte një nga inciativat e rëndësishme të Bankës për vitin 2018. Zgjerimi në trevat shqipfolëse është një nga objektivat e zgjerimit të biznesit të bankës Credins. Projekti i parë i ndërmarrë është ai i themelimit të Credins Bank Kosova. Gjatë këtij viti, është punuar kryesisht në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor dhe aprovimet në forumet e brendëshme të Bankës. Projekti është në fazë të përparuar, është aplikuar për licencën e ushtrimit të aktivitetit pranë Bankës Qëndrore të Kosovës.

- Një tjetër iniciativë e rëndësishme e Bankës, është 'mapimi' i proceseve në nivel intitucioni. Ky projekt ka si objektiv të analizojë dhe vizualizojë proceset, ndarjen e roleve dhe përgjegjësive, nivelet e kontrollit si dhe mënyrën e ndërveprimit midis tyre, me qëllim thjeshtëzimin dhe përmirësimin e efiçencës së proceseve në bankë. Gjatë vitit 2018, ka përfunduar faza e parë e vlerësimit dhe pritet që gjatë vitit 2019 vihet në zbatim faza e dytë e 'mapimit' të proceseve të cilat janë vlerësuar si më kritiket.

- Depozitari është një projekt në fazë të avancuar për të cilën është punuar gjatë vitit 2018. Është përgatitur i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe shumë shpejt pritet leja për ushtrim aktiviteti nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- Projekti COSME. Një tjetër iniciativë e rëndësishme e ndërmarrë nga banka gjatë vitit 2018 dhe që pritet të finalizohet gjatë vitit 2019, është lidhja e marrëveshjes me Fondin Europian të Investimeve për fondin e garancisë në vlerën € 7.5 mln në mbështetje të kreditimit të sektorit të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme. Kjo marrëveshje konsiderohet e një rëndësie të veçantë për institucionin në nivelin reputacional dhe operacional.

- Edhe gjatë vitit 2018, ka vazhduar programi i modernizimit dhe përmirësimeve teknologjike në Bankë në mbështjete të objektivit strategjik për të gjeneruar më shumë biznes nëpërmjet 'digital banking'. Gjatë vitit 2018, janë bërë investime të konsiderueshme në mbështetje të transformimit të biznesit dhe forcimit të infrastruktures IT nëpërmjet digjitalizimit, zhvillimeve teknologjike të sistemeve dhe zhvillimeve të vazhdueshme të infrastrukturës. Platforma 'Credins Online' ka pësuar transformime të rëndësishme si në shtimin dhe përmirësimin e funksionaliteteve por edhe në thjeshtëzimin e mënyrës së përdorimit nga klientët.

€ 7.5 MILION NË MBËSHTETJE TË KREDITIMIT TË SEKTORIT TË BIZNESEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME.

DEPARTAMENTI OPERACIONAL

Departamenti Operacional, si struktura qëndrore në mbështetje të procesimit korrekt dhe në kohë të të gjithë pagesave jashtë banke, brenda dhe jashtë Shqipërisë, vazhdoi edhe përgjatë 2018 të përmbushë me profesionalizëm dhe efektivitet rolin e tij, duke kontribuar në rritjen e vazhdueshme të cilësisë së procesimit të volumeve të transaksioneve të pagesave dhe instrumentave të 'Trade Finance'.
Nje hap i rëndësishëm është bërë në automatizimin e procesimit të transfertave në mbërritje në mënyrë të drejtëpërdrejtë - STP (Straight Thruogh Processing), duke rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e procesimit të tyre.



50% RRITJE E PAGESAVE NËPËRMJET E-BANKING

Në Nëntor 2018, Credins Bank bëri efektiv standartizimin e mesazheve të pagesave (MT103 dhe MT202) për Kodin Unik të Transaksionit - UETR – Uniqe End-to-End Transaction Reference, sipas kërkesave të SWIFT. Kjo është referenca unike e cila shoqëron transaksionin nga krijimi deri në procesimin përfundimtar të pagesës, pavarësisht referencave të secilës bankë nëpërmjet së cilës procesohet pagesa, dhe i hap rrugë gjurmimit të pagesave përgjatë zinxhirit të procesimit të tyre.
Credins Bank, përgjatë vitit 2018, ka procesuar në kohë reale nëpërmjet sistemeve AIPS dhe AECH një fluks të konsiderueshëm të transfertave në nisje në monedhën kombëtare, me një rritje prej 10% në vlerë, dhe 24% në numër transaksionesh, krahasuar me vitin 2017. Transfertat në mbërritje, në monedhën kombëtare, kanë një rritje prej 4% në vlerë dhe 19% në numër transaksionesh.
Transfertat në monedhë të huaj, shënuan gjithashtu rritje, duke reflektuar vlerat si më poshtë. Kështu transfertat në nisje 'monedhë e huaj', shënuan një tregues me një rritje prej rreth 10% në vlerë dhe 23% në numër transaksionesh, ndërkohë që transfertat në mbërritje në valutë, me një rritje prej 35% në vlerë, dhe 57% në numër transaksionesh, krahasuar me vitin 2017. Si rrjedhojë e këtyre volumeve, komisionet nga shërbimi i transfertave, brenda dhe jashtë vendit, kanë vijuar të shënojnë rritje krahasuar me vitin 2017.

Po ashtu vlen të përmendet përditesimi i shërbimit e-banking, duke u ofruar me një 'design' të ri dhe një mënyrë përdorimi më të lehtë, për përdoruesit. Pagesa e detyrimeve utilitare, tatim-taksat, doganat, ZRPP, vijnë në një mënyrë më të shpejtë e të thjeshtë për përdoruesin. Asistenca e vazhdueshme e klientëve dhe punonjësve në degë për këtë shërbim ka qenë gjithmonë prezente dhe efikase.
Është vërejtur një rritje e pagesave nëpërmjet e-banking, me rreth 50% të transaksioneve, krahasuar me vitin 2017.
Instrumentat e 'Trade Finance' si Letër-kreditë, Garancitë me jashtë dhe 'incaso'-t, vijuan të jenë pjesë e pagesave dhe angazhimeve bankare, duke iu ofruar klientëve një shërbim profesional, korrekt dhe cilësor të këtyre instrumentave.
Tregues të kënaqshëm janë shënuar në fushën e pagesave utilitare me rritje të volimit të tyre me rreth 22% në vlerë dhe 28% në numër transaksionesh, më shumë se viti 2017.
Pagesat e Tatimeve dhe Doganave, po ashtu u rritën me rreth 18%, në vlerë, 57% në numër transaksionesh dhe po ashtu rritje të komisioneve të arkëtuara. Credins Bank është një nga bankat kryesore në vend për shërbimin e procesimit të pagave për kompanitë dhe institucionet shtetërore, me një trend në rritje përgjatë vitit 2018. Po ashtu një trend gjithnjë e në rritje të ndjeshme vërehet në procesimin e pensioneve nëpërmjet Bankës, në zbatim të marrëveshjes së lidhur midis Bankës dhe ISSH.

DEPARTAMENTI I THESARIT

Departamenti i Thesarit në Bankën Credins, ka arritur të menaxhojë me efektivitet likuiditetin e Bankës duke minimizuar impaktin negativ ndaj risqeve të paraqitura në tregjet financiare përgjatë vitit 2018. Organizimi dhe planveprimi me profesionalizëm në investimet e kryera ka ofruar mbështetje në aktivitetin kryesor të Bankës dhe stabililitet në tregun bankar vendas. Eksperienca shumëvjecare si edhe trajnimet profesionale të punonjësve në Departamentin e Thesarit, janë pasqyruar në rezultatet pozitive për vitin 2018 si dhe në edukimin e stafit dhe klientëve të Bankës. Volumet e larta të këmbimit valutor për vitin 2018 kanë zgjeruar ndjeshëm marrëdhënien e bashkëpunimit me bankat jorezidente duke sjellë rritje të besueshmërisë dhe ulje të kostove të tregtimit. Departamenti i Thesarit ka pozicionuar Bankën si lider në tregun financiar vendas, pikërisht duke ofruar klientëve mundësinë e tregtimit valutor përgjatë 24 orëve dhe këmbimin e monedhave dytësore. Zhvillimet për BREXIT I kanë dhënë rëndësi të veçantë tregtimit të GBP (poundi britanik) përgjatë vitit 2018.
Për më tej, një nga objektivat e Departamentit të Thesarit ka qënë dhe mbetet mundësia e këmbimeve apo pagesave në monedhën kineze CNY, për kompani që kryejnë transaksione me Kinën.
Menaxhimi i fondeve 'cash' për degët e Bankës ka qenë një ndër projektet e rëndësishme të Departamentit të Thesarit përgjatë vitit 2018. Përmbushja në kohë dhe me kosto më të ulët për Bankën e kërkesave të klientëve për fonde 'cash' ka sjell rritje të bashkëpunimit dhe siguri për klientët.
Banka ka marrë pjesë në implementimin e projektit pilot të Bankës Botërore për ankandin e obligacionit referencë 5 vjecare, ku ka përmbushur me sukses kërkesat dhe duke sjell edukimin e stafit të bankës dhe të klientëve në lidhje me investimin në letra me vlerë.
Banka Credins është angazhuar në zhvillimin e tregtimit të letrave me vlerë në tregun sekondar duke zgjeruar bazën e klientëve që shërben, duke mbështetur klientët në investimet e tyre me kosto më të ulët dhe shërbim transparent e cilësor. Viti 2018, rezultoi një vit i suksesshëm gjithashtu edhe në emëtimet e reja të obligacioneve të Credins Bank ku kërkesa tejkalonte ofertën. Klientët e shikojnë këtë produkt të Credins Bank si një alternativë shumë të mirë investimi.
Përveç kujdestarisë për letrat me vlerë të qeverisë shqiptare, viti 2018 shënoi rritje të volumeve në kujdestarinë për obligacionet e emetuara nga shoqeritë aksionare, duke dhënë suportin dhe eksperiencën e saj shumëvjeçare për realizimin me sukses të këtyre emetimeve.
Departamenti i Thesarit, edhe pse ka realizuar me sukses detyrat gjatë vitit 2018 duke rezultuar në rritje të fitimeve dhe ulje të kostove në produkte, duke ofruar qëndrueshmëri e rritje të bashkëpunimit me bankat rezidente dhe jo-rezidente, vazhdon të jetë në kërkim të metodave dhe zgjidhjeve më efektive në menaxhimin e likuiditetit. Menaxhimi efektiv i likuiditetit, fleksibiliteti, kostoja e ulët, shpejtësia në veprime, tregtimi 24 orë i monedhave dhe transparenca janë ndër objektivat dominuese të Departamentit të Thesarit, të cilat edhe për vitin 2018 çuan në rritjen e fitimeve jo vetëm për Credins Bank por edhe për klientët. Ndjekja e ecurisë së tregjeve financiare nga një staf i kualifikuar dhe ofrimi i mundësive më të mira për klientët në lidhje me investimet, kanë qenë dhe mbeten një sfidë e vazhdueshme për Departamentin e Thesarit.
Një ndër objektivat e Departamentit të Thesarit është ofrimi i investimeve alternative në tregjet financiare për klientët e Bankës, sidomos gjatë kësaj periudhë që përfitimet nga interesat e depozitave kanë qëndruar në nivele të ulëta.

DEPARTAMENTI I THESARIT KA POZICIONUAR BANKËN SI LEADËR NË TREGUN FINANCIAR VENDAS, DUKE I OFRUAR KLIENTËVE MUNDËSINË E TREGTIMIT VALUTOR PËRGJATË 24 ORËVE DHE KËMBIMIN E MONEDHAVE DYTËSORE.

DEPARTAMENTI I KARTAVE

Credins Bank, ka qënë dhe vazhdon të mbetet ndër bankat e para në promovimin, mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimeve në fushën e pagesave elektronike. Të ndërgjegjshëm për rolin dhe nevojën e përfshirjes, është synuar gjithmonë zgjerimi i vazhdueshëm i portofolit të produkteve dhe shërbimeve të kartave. Credins sot mbulon nevojat dhe kërkesat e klientëve individë dhe biznese (private dhe publike) me produkte Visa dhe MasterCard debiti dhe krediti, në Lek dhe në valutë. Në Credins gjejnë zgjidhje për nevojat e tyre të gjithë kategoritë e klientëve.

Kartat Visa të parapaguara, kanë qënë një risi absolute dhe një sukses i menjëhershëm në tregun bankar shqiptar. Për këtë Visa ka përgatitur një "case study" për kartat e parapaguara Credins, të cilin do ta përfshijë si nje rast suksesi në "best practices" në faqen e saj online.

Karta 'MasterCard prepaid' në Euro, edhe pse u ofrua disa vite më vonë (Shtator 2016), pati të njëjtin sukses dhe u prit me të njëjtin entuziazëm nga klientët. Treguesit sasiorë dhe cilësorë në rritje të këtij produkti, janë afirmimi i një përqasje të drejtë të bankës ndaj këtij segmenti. Kartat e parapaguara kanë siguruar përfshirjen në sistemin bankar të pagesave, edhe të individëve jo klientë të bankës, duke rritur kështu ndër të tjera edhe kontributin e bankës në edukimin financiar dhe në përmirësimin e treguesve të përfshirjes financiare.

Në 2017 numri i kartave 'MC prepaid' në Euro ishte 7 mijë e 580, ndërkohë që në 2018 ky numër arriti në 13 mijë karta, me volume përkatësisht 405 milion lekë dhe një rritje të ndjeshme në 1037 milion lekë në 2018 (1 miliardë e 37 milion lekë).

Me synimin për të qenë sa më pranë klientit me zgjidhjet dhe alternativat më të fundit bashkëkohore, në 2018 banka është përfshirë ndër të tjera edhe në projektet më poshtë:

- Është përfunduar me sukses projekti për rritjen e sigurisë së blerjeve online me kartat Credins, nëpërmjet autentifikimit të transaksioneve online me një kod njëpërdorimësh sigurie (OTP – one time password); duke i bërë blerjet online me kartat Credins edhe më të sigurta.
- Ka përfunduar projekti me Visa-n për sponsorizimin e ABI Bank për transaksionet me kartat Visa dhe është në përfundim i njëjti projekt me bankën ICB.
- Ka përfunduar dhe është në fazën e testimeve projekti "Visa PIN change on ATMs" nëpërmjet të cilit klienteve ju ofrohet mundësia e ndryshimit të PIN-it në rrjetin e ATM-ve të bankës (për MC kjo ofrohet aktualisht)
- Ka filluar dhe është në proces projekti për 'Visa contactless' (aktualisht të gjitha produktet MC janë të tilla)

Banka ka zgjeruar aktivitetin e saj me kartat 'Visa Business' për institucionet publike. Në 2018 është shtuar numri i institucioneve të rëndësishme që përfitojnë nga avantazhet e këtij produkti, dizenjuar dhe përshtatuar për këtë kategori të veçantë të klientelës. Me një zgjidhje origjinale në funksion të natyrës specifike të këtyre institucioneve, një numër gjithmonë e më i madh i tyre gjejnë tek Credins një partner të besueshëm që i jep zgjidhje professionale të përshtatshme për kërkesat e tyre.

Edhe përgjatë 2018 në fokus ka qënë implementimi dhe perfeksionimi i teknologjive të reja, përmirësimi i elementeve të sigurisë në lëshimin dhe pranimin e kartave, zbatimi i skemave të besnikërisë, etj. Credins Bank është e para dhe e vetmja bankë në sistemin bankar që ofron produktet 'MasterCard World', të cilat janë të teknologjisë 'contactless', të thjeshta, komode dhe të sigurta në përdorim dhe kanë vlerë të shtuar për klientin i cili ka gjithashtu edhe përfitime shtesë si sigurim jetë në udhëtim, asistencë, ofrimi i shërbimit të zëvendësimit të kartës në rast emergjence, skemë besnikërie, etj.

Sfida jonë e vazhdueshme mbetet cilësia e lartë e produkteve dhe e shërbimeve; portofoli i gjerë dhe me alternativa për të gjithë bizneset dhe individët klientë ose jo të bankës; siguria e lartë në përdorimin e produkteve dhe shërbimeve tona; ofrimi i zgjidhjeve më të fundit bashkëkohore që kanë në qendër klientin.

DEPARTAMENTI I IT-SË

Strategjia e bankës për të qenë në pararojë të tendencave të tregut në fushën teknologjike ka udhëhequr njësitë e biznesit në zhvillimin e ofrimin e produkteve të reja inovative. Credins Bank ka një pozicion kyç në fushën e inovacionit dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përputhje me strategjinë e saj të digjitalizimit. Credins zhvilloi një platformë të re të 'Credins Online' përmes teknologjisë më të fundit për t'i shërbyer të gjithë segmenteve të klientëve të saj individë, biznese të vogla dhe të mesme apo koorporata, duke i mundësuar atyre të kryejnë veprime bankare online. Kjo platformë rriti në mënyrë të konsiderueshme komoditetin e klientëve dhe lehtësinë në përdorimin kanalit të bankingut digjital. Credins Online, ofron një numër të madh funksionalitetesh duke filluar nga kontrolli i historikut të detajuar të veprimeve deri në pagesat e faturave mujore, taksave të ndryshme, kartës së kreditit dhe transferta drejt palëve të treta brenda bankës, brenda apo jashtë vendit në kohë reale. Shërbimi i bankingut digjital ofron dhe ka suport në çdo kohë 24/7 dhe mbrohet me teknologjinë më të fundit të sigurisë.

Gjatë 2018, departamenti i IT-së vazhdoi të mbështesë operacionet në rritje të bankës duke siguruar funksionimin e të gjithave sistemeve. Viti 2018 ka qenë viti i ndyshimeve të mëdha përsa i përket zhvillimit të bankës digjitale ku shumë vlen të përmenden;

Platforma Credins Online me funksionalitete të reja dhe tani me një tjetër dizajn e thjeshtësi në përdorim, **DataWaarehouse dhe Business Intelligence** i cili mundëson gjenerimin e raporteve automatike në përputhje me nevojat e identifikuar nga Divizioni Zhvillimit të Biznesit, JeniuX për automatizimin e printimit të kontratave të shërbimeve dhe produkteve të bankës e cila përmirësoi dukshëm kohën e shërbimit të klientit, si edhe shumë përmirësime në infrastrukturën dhe punën e përditshme operacionale. Departamenti i IT ka vazhduar të jetë një nga shtyllat kryesore mbështetëse në plotësimin e kërkesave të nevojshme dhe efektive për realizimin e projekteve të ndërmarra gjatë këtij viti, për gjenerimin dhe sigurimin e bazës së nevojshme me të dhëna që ndihmojnë vendimmarrjen e përditshme të të gjithë departamenteve.

CREDINS ONLINE GJATË VITIT 2018

81,836
PËRDORUES

83,374
VEPRIME TE KRYERA

ORË TRAJNIMI

CREDINS I JEP RËNDËSI ZHVILLIMIT TË STAFIT ME PËRDITËSIMET E REJA NË TREGUN KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR BANKAR. GJATË VITIT 2018 JANË TRAJNUAR 735 PUNONJËS ME TË PAKTËN NJË TRAJNIM.

DUKE PROMOVUAR RESPEKTIN, DIVERSITETIN, NDERSHMËRINË DHE PERFORMANCËN INDIVIDUALE NË VENDIN E PUNËS, NE PËRPIQEMI TË ARRIJMË REZULTATET MË TË MIRA PËR KLIENTËT TANË, DUKE U KRENUAR ME ARRITJET E CREDINS BANK NDËR VITE. NE VAZHDOJMË TË FOKUSOHEMI NË RËNDËSINË QË KA KRIJIMI I NJË KULTURE, BAZUAR MBI VLERAT NJERËZORE QË NA UDHËHEQIN, DUKE IDEUAR DHE PËRMBUSHUR KËSHTU STRATEGJINË AFATGJATE TË CREDINS BANK.

NDARJA E STAFIT SIPAS GJENERATAVE TË NDRYSHME

59% E STAFIT
GJENERATA Y,
MOSHA 22-35 VJEÇ

29% E STAFIT
GJENERATA X,
MOSHA 36-50 VJEÇ

12% E STAFIT
BABY BOOMERS,
MOSHA MBI 51 VJEÇ





DIVERSITETI I STAFIT

Në kuadër të zbatimit të strategjisë së Burimeve Njerëzore edhe për vitin 2018 është punuar për rritjen e diversitetit të kapitalit njerëzor brenda bankës me qëllim përfshirjen e diferencave të ndryshme në sjellje, vlera, specializime funksionale, stile pune dhe kjo shikohet qartë në raportet e më poshtme të ndarjes së gjeneratave dhe raportin meshkuj/femra. Në Credins punohet si në një familje.

REKRUTIMI

Gjatë vitit 2018 kemi vazhduar të rrisim ambicien tonë, për t'u bërë punëdhënësi më i kërkuar dhe gjithëpërfshirës, ku punonjësit tanë ndjehen të motivuar për të dhënë maksimumin në punë. Promovimi dhe rritja në karrierë e punonjësve të Bankës është pjesë integrale e strategjisë së Burimeve Njerëzore, ku vetëm gjatë vitit 2018 janë promovuar 117 punonjës të brendshëm në pozicione të reja. Credins Bank ka qenë e pranishme në Panairet e Punës dhe të Studimit të organizuara nga institucionet më të rëndësishme në vend siç janë Zyrat e Punës, Bashkia Tiranë dhe disa Institucione të Arsimit të Lartë me qëllim përthithjen dhe rekrutimin e studentëve, kryesisht të ekselencës.
Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 753 intervista pune, nga ku janë rekrutuar 142 studentë dhe punonjës me eksperiencë bankare, nga të cilët 15 kanë qenë praktikantë sipas marrëdhënieve të përvitshme që Banka Credins mban me Ministrinë e Mirëqënies Sociale si dhe Bashkinë e Tiranës.

TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI ËSHTË PJESË THELBËSORE E SUKSESIT TË CREDINS BANK.

Investimi në zhvillimin, trajnimin dhe vlerësimin e asetit më të rëndësishëm të bankës, kapitalit njerëzor ishte në fokus të politikave të menaxhimit të bankës edhe për vitin 2018.

Ndër vite Credins Bank ka zhvilluar trajnime të vazhdueshme të stafit për ndërtimin e një skuadre profesionistësh dhe ekspertësh në fushën e bankingut për një drejtim të suksesshëm të bankës. Për këtë, ne kemi investuar gjatë gjithë vitit 2018 duke i përfshirë punonjësit në trajnime të ndryshme dhe projekte të cilat rrisin njohuritë dhe kualifikimin e tyre.

Programet tona të trajnimit përqendrohen në zhvillimin e aftësive të punonjësve në nivel stafi dhe në nivel manaxherial. Të gjithë punonjësve tanë i ofrohet mundësia e përfshirjes në kurse dhe trajnime brenda bankës me ekspert të brendshëm por dhe trajnime me trajnues ndërkombëtarë.

Credins i jep rëndësi zhvillimit të stafit me përditësimet e reja në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar Bankar, ku vetëm gjatë vitit 2018 janë trajnuar jashtë vendit 15 punonjës të bankës dhe 96 punonjës janë trajnuar jashtë bankës në institucione trajnuese të mirënjohura në fushën e trajnimeve në Shqipëri.

GJATË VITIT 2018 JANË ZHVILLUAR NË TOTAL 42,206 ORË TRAJNIMI NGA TË CILAT

12,526
ORË TRAJNIME PËR STAFIN EKZISTUES

22,720
ORË TRAJNIME PËR PUNONJESIT E RINJ

6,960
ORË TRAJNIME PËR STAFIN E PROMOVUAR

735
PUNONJES TË TRAJNUAR TE PAKTEN NJE HERE GJATË 2018

6.7
DITË TRAJNIMI KA MARRË MESATARISHT NJË PUNONJËS

LEKË

INVESTIME TË REALIZUAR NGA CREDINS GJATË 2018
PËR OBJEKTIVIN 4 PËR NJË ARSIM CILËSOR

PËRGJEGJËSIA SOCIALE NË CREDINS BANK 2018

Aktivitetet e ndërmarra dhe mbështetura nga Credins Bank, në kuadër të Përgjegjësisë Sociale në përputhje me 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm.

OBJEKTIVI 2 ZERO URI

Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme!

Credins Bank i kushton një vëmendje të veçantë kontributit në mbështetje të eleminimit të urisë në çdo lloj forme. Gjatë vitit 2018 Banka ka bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në eliminimin e varfërisë për shtresat në nevojë dhe për fëmijet pa përkujdesje prindërore. Credins Bank është një institucion gjithmonë në mbështetje të promovimit të një jetese të mirë dhe ka një rol kyç në sensibilizimin e popullsisë për një mirëqenie dhe jetesë të shëndetshme.

- Në mbështetje të këtij objektivi, edhe gjatë 2018, Credins vazhdoi të mbulojë shpenzimet për 3 fëmijë në fshatin SOS duke nxitur fuqizimin e mëtejshëm të: "SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë", për t'i dhënë akoma më shumë mundësi fëmijëve në Shqipëri dhe investuar në një shtëpi të lumtur.

OJEKTIVI 4 ARSIM CILËSOR

Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës.
Credins Bank beson se arsimi, arti, kultura dhe informimi i gjerë, janë një nga kontributet më të çmuara në dobi të komunitetit dhe zhvillimit të vazhdueshem. Rritja dhe përfshirja e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi teknike dhe profesionale për punësim, punë të denja dhe sipërmarrje është thelbësore në ndërtimin e një shoqërie dhe komuniteti më të fortë dhe qëndrueshëm. Në kuadër të politikave të përgjegjësisë sociale, ky kontribut është reflektuar përmes mbështetjen financiare të një sërë aktiviteteve të tilla si:

- Në kuadër të Javës Globale të Parasë 2018, Credins Bank mbështeti Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB) në aktivitetet dhe organizimet e ndërmarra.

- Credins mori pjesë në takimin e organizuar me studentë në Universitetin e Durrësit. Takimi i cili synonte edukimin, fuqizimi dhe ndërgjegjësimin financiar për të rinjtë e universitetit. Në këtë aktivitet, Credins, u përfaqesua nga znj.Elona Barxhani, drejtore e Degës Durrës.

- Credins Bank, në mbështetje të trashëgimisë Shqiptare ndër vite, mbështeti botimin e Katalogut "Gimjani – Pulla Shqiptare". Një katalog i cili vjen si një vlerë e munguar në trashëgiminë e filatelisë Shqiptare. Në prag të 105 Vjetorit të pullës së parë Shqiptare, autori Muharem Gimjani sjell katalogun e pullave të emetuara nga Posta Shqiptare në vitet 1913 – 2017.

- Credins Bank mbështeti Shoqatën Shqiptare të bankave në organizimin e Kuizit Europian të Parasë, konkursi mbarë evropian, i cili u organizua për herë të parë në vitin 2018, me qëllim përmirësimin e kulturës financiare të fëmijëve të moshës 13–15 vjeç.

- Në kuadër të edukimit financiar dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve, Credins Bank, gjata muajit Shtator zgjodhi të jetë pranë fëmijëve të cilët nisin vitin e ri shkollor. Nën Moton "Unë di të Kursej" banka ka ideuar një udhëzues për prindërit dhe fëmijët e cilit 9-vjeçar. Në formën e një udhëtimi nga klasa e parë deri në të nëntën, Credins inkurajon dhe këshillon nxënësit drejt kulturës së kursimit dhe ndërgjegjësimit financiar.

- Në kuadrë të politikave të bankës për mbështetjen e të rinjve në fushën e inovacionit, Credins mbështeti ekipin e të rinjve që përfaqësoi Shqipërinë në Olimpiadën Robotikës në Meksikë.

- Credins Bank, në kuadër të politikave të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të vazhdueshëm promovoi akoma më tej sipërmarrjen e të rinjve, duke mbështetur Tirana Business University në këtë iniciativën: "Sipërmarrësit e së Nesërmes" dhe "Juristët e Së Nesëmres", e cila është tashmë nje traditë e TBU në nxitje të ideve të reja, frymës së konkursit dhe spikatjen e ideve të biznesit të cilat kontribuojnë në zhvillim të vendit.

- Aksesi në arsim dhe edukimi ndihmon në krijimin e një të ardhmeje të ndritur për të gjithë të rinjtë në mbarë botën. Në Ditën Ndërkombëtare të Kursimit, CredinsBank vendosi të ishte pranë nxënësve të shkollave 9-Vjeçare "Kushtrimi i Lirisë" dhe "Shkolla e Kuqe". Në bashkëpunim me degët Credins, banka dhuroi 1500 fletore, në të cilat integrohej edhe një udhëzues financiar për prindërit dhe fëmijët e ciklit 9-vjeçar, i quajtur "Unë di të Kursej". Studimet e tregut konfimojnë se përfshirja e fëmijëve në moshë sa më të re drejt kulturës së kursimit dhe ndërgjegjësimit financiar sjell rezultate pozitive në sjelljen e tyre financiare si të rritur.

- Pjesë e angazhimit të drejtuesve të lartë ekzekutivë në Credins është dhe kontributi personal në edukimin financiar të fëmijëve. Monika Milo, Zv Drejtore e Përgjithshme e Credins bank priti për një bashkëbisedim në zbulim të njohurive të para mbi bankën, kursimin , kredinë , dhe sistemin bankar, një grup nxënësish të klasës së dytë nga World Academy of Tirana.

OBJEKTIVI 9 INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

Ndërtimi i një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

Credins Bank, ka investuar dhe zhvilluar politika për mbështetjen me financim të projekteve në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve jetësore. Gjatë 2018, banka ka kontribuar për institucionet publike dhe jopublike, duke investuar në zhvillimin e një infrastrukture cilësore, e duke i bërë këto instutucione të besueshme, të qëndrueshme dhe efikase në shfrytëzimin e burimeve dhe përdorim më të madh të teknologjive. Mbështetje e cila ka sjellë në mënyrë paralele nxitjen e mirëqënies njerëzore.

- Banka, mbështeti Qendrën Shëndetësore të Specialistëve Nr.3 duke mbuluar shpenzimet për restaurimin e ambjenteve së kësaj poliklinike.

- Credins Bank, në kuadër të përkujdesjes të vazhdueshme për mirëqënie, progresit dhe zhvillimit të mjedisit ku ushtron aktivitetin e saj, dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, institucion i veçantë shëndetësor i të burgosurve, Komisarjati i Policisë Mallakastër, Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Zyrën Arsimore Kamëz, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mallakaster dhe Njësia Administative Nr.2, Tiranë.

- Credins Bank, dhuroi pajisje elektronike për Prefekturën Tiranë. Në kuadër Përgjegjësisë Sociale, Credins, kontribuon për përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

- Në kuadër të përkujdesjes ndaj ambjentit dhe komunitetit, Credins Bank dhuroi për Bashkinë Kamëz 45 pemë kumbulle, duke kontribuar në shtimin e zonës së gjelbër dhe ofrimin e ambjenteve më të këndshme për banorët e zonës.

- Credins Bank, ka investuar dhe zhvilluar politika për mbështetjen me financim të projekteve në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve jetësore. Banka, mbështeti Qendrën Shëndetësore Katund i Ri Shkozet, duke dhuruar karrige për ambjentet e brendshme të kësaj poliklinike si dhe Spitalin Universitar të Traumës, Spitalin Rajonal Shkodër, Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1 dhe Qendrën Shëndetësore Nr.4, duke restauruar dhe dhuruar pajisje për përmirësimin e kushteve të brendshme dhe për ambjentet e brendshme të këtyre institucioneve.
- Pjesë e politikave të përgjegjësisë sociale dhe tregues për përkujdesjen për ambjentin dhe komunitetin në të cilin operon,

Credins ka nisur të përdori makinat elekrike në kryeqytet duke bërë edhe një hap më pranë inovacionit dhe dixhitalizimit fale sistemeve inteligjente me të cilat ato operojnë por mbi te gjitha duke ulur ndikimin negative mbi ambientin.

◆ Credins Bank, ka restauruar dhe dhuruar pajisje për përmirësimin e kushteve të brendshme dhe për ambjentet e brendshme të këtyre institucioneve: Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 sh.a, Shkollën "Isa Boletini", IEVP Fushë Krujë, DRSH Dibër dhe Qendrën Shëndetësore Nr.1 duke

◆ Credins Bank, dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: AZHBR, Ujësjellës Kanalizime Mallakastër, Trajtimi i Studentëve, Shtëpia e Pushimit Ministria e Brendshme, Qendrën Shëndetësore Nr.8 si dhe Klubi Shumësportësh Studenti.

CREDINS BANK GJATË VITIT 2018 KA MBESHTETUR MË SHUMË SE

40
INSTITUCIONE SHTETËRORE

OBJEKTIVI 10 ZVOGELIM I PABARAZIVE

◆ Credins Bank, në kuadër të fuqizimit të figurës së gruas, mbuloi shpenzimet për aktivitetin e zhvilluar në Burgun e Grave Tiranë, gjithashtu dhuroi pajisje estetike për të gjitha të burgosurat.

◆ Edhe këtë vit, Credins Bank pati kënaqësinë të bashkëpunojë me Doën Syndrome Albania dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë. Në kuadër të Përgjegjësisë Sociale dhe përkujdesjes ndaj komunitetit, ne kemi blerë kartolina pranë këtij fondacioni, për të uruar klientët tanë për festat e funditit duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj nevojave të fëmijëve në nevojë.

OBJEKTIVI 11 QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme!

Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete kulturore dhe promovuese të artit në të gjithë vendin. Nëpërmjet finiancimit të këtyre iniciativave, banka synon të forcojë dhe nxisi përpjekjet për të mbrojtur dhe garantuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës. Një tjetër aspekt i këtij kontributit gjatë 2018, ishte ofrimi i aksesit në hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të gjelbërta. Bërja e qyteteve dhe komunitetit të qëndrueshëm kërkon mbështetje edhe për ato vende të cilat janë më pak të zhvilluara, në këtë kuadër, banka ka ndihmuar financiarisht dhe teknikisht për ndërtimin e ndërtesave dhe institucioneve të qëndrueshme dhe elastike.

◆ Credins Bank, në Ditën Ndërkombëtare të Ambjentit prezantoi, përmes nje vidjoje të shkurtër Ryan-in. Një sipërmarrës i vogël i cili jo vetëm na edukon financiarisht por edhe ndërgjegjëson për mbrojtjen e ambjentit përmes iniciativës së tij.

◆ Me rastin e 1 Qershorit, Credins Bank zgjodhi të ishte pjesë e "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve", me nxënësit e shkollës "Adem Myrta" në fshatin shpërdhet në mamurras, të shoqëruar nga mësuesja e tyre zonja Angjelina Gjonikaj, si dhe trajnerët e tyre Agustin Luli dhe Xhulian Gjonikaj, i dhuruan pavionit të spitalit onkopediatrik në tiranë, punimet e tyre të realizuara në workshop-in "Fëmijët, Arti dhe Ricklimi".

◆ Credins Mbështeti Shoqatën "Eja Në Teater" duke mbuluar shpenzimet e venies në skenë të shfaqes "Komedia që Shkon për Dreq". Duke mbështëtur në këtë formë artin dhe artistët në Shqipëri.

◆ Credins Mbështeti Shoqatën Orafilm – Marubi sh.p.k duke mbuluar shpenzimet e projektit "Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri – Edicioni 13". Duke kontribuar në bërjen e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme!

OBJEKTIVI 17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm.

◆ Credins Bank mbështeti Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH) në organizimin e Konferencës së V-të Farmaceutike. Nën sloganin "Së Bashku Për Farmaceutikën" konferenca synoi një informim akoma më të gjerë dhe diskutim mbi zhvillimet farmaceutike në Shqipëri.

◆ Si një institucion partner me bizneset dhe institucionet lokale, Credins Bank, gjatë muajit Maj, ishim të pranishëm në aktivitetin: "Prezantim i Modeleve të Sipërmarrjeve, Rrjetëzim dhe Partneritet me Biznesin" organizuar nga Partners Albania. Credins Bank vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetje të projekteve të ndryshme të cilat nxisin zhvillimin vendas.

◆ Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Credins Bank, me rastin e festës së fëmijëve, 1 Qershorit, organizoi dhe mbeshteti aktivitete me karakter sportiv për të gjithë fëmijët e qytetit të Tiranës pranë parkut të liqenit.

◆ Rreth 170 studies nga Shqipëria, rajoni edhe më gjerë morën pjesë në edicionin e 8-të konferencës ndërkombëtare të Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", me temë "Politikat Ekonomike dhe Integrimi Europian", ku ndanë idetë dhe gjetjet e tyre sa i përket fushës së ekonomisë.
Si një institucion partner i shumë eventeve të rëndësishme në fusha të ndryshme, edhe kësaj here, Credins Bank mbështeti këtë aktivitet me rëndësi të lartë për botën akademike.

◆ Si një institucion partner me bizneset dhe institucionet lokale, Credins Bank, gjatë muajit Korrik, sponsorizoi aktivitet për stafin e Burgur të Drenoveës. Credins Bank vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetje të projekteve të ndryshme të cilat nxisin zhvillimin vendas.

GJATË VITIT 2018 CREDINS BANK KA INVESTUAR NE OBJEKTIVIN 4: ARSIM CILËSOR ME MBI

5,440,000
LEKË

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR VITIN 2018 NGA CREDINS BANK KA QENË

29,373,400
LEKË

KULTURË, ART DHE SPORT

◆ Atletika shqiptare priti turneun ndërkombëtar të atletikës, i cili u mbajt në pistën e stadiumit kombëtar 'Elbasan Arena'. 140 sportistë nga Armenia, Italia, San Marino, Mali i zi, Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria garuan më 23 maj në 8 disiplina të ndryshme. Credins Bank në kuadër të Përgjegjësisë Sociale mbështet këtë aktivitet të akredituar në kalendarin sportiv të vitit 2018 të federatës evropiane të atletikës.

◆ Në daten 14 Prill 2018, Credins Bank mbështeti Koncertin Jubilar "Nostalgji" të organizuar në Sallën Koncertale të Katedrales Ortodokse. Gjithashtu, Credins, sponsorizoi projektin "Be DiFFeREnt" nga Fondacioni ARKU. Projekti erdhi në formën e një shfaqeje koreografike me 1 akt dhe 7 tablo. Një produksion nga Rovena Dilo, me koreografi nga Eltion Merja dhe Regji nga Endri Roshi. Në këtë mënyrë, banka mbështet dhe promovon në këtë mënyrë artin dhe artistët në Shiqpëri.

◆ Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete kulturore, sportive dhe promovuese të artit në të gjithë vendin. Credins, sponsorizoi Federatën Shqiptare të Snookerit, në organizimin e Kampionatit të Snookerit 2018.

◆ Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete kulturore, sportive dhe promovuese të artit në të gjithë vendin. Credins, sponsorizoi Aeronatikën Shqiptare, në organizimin e "Korca Open Air"

RRJETI I DEGËVE



59 BRANCHES

69 ATM

RAPORTI I
AUDITOREVE

BANKA CREDINS SHA

Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

PËRMBAJTJE

Raporti i Audituesit të Pavarur ..... i-iii
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes 1
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 2
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar 3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit 4
Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare 5
1 Informacion i Përgjithshëm 6
2 Bazat e përgatitjes 6
2. Net Interest income 26
4 Të ardhura neto nga komisionet 26
5 Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto 27
6 Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë 27
7 Shpenzime Personeli 27
8 Shpenzime Administrative 27
9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin 28
10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to 28
11 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore 29
12 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare 30
13 Letra me vlerë me VDPFH (të mbajtura për tregtim) 31
14 Letra me vlerë të investimit 32
15 Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje 34
16 Qira financiare 35
17 Hua dhe paradhënie klientëve 37
18 Prona të riposeduara 39
19 Aktive afatgjata materiale 40
20 Aktive jo-materiale 41
21 Aktive të tjera 41
22 Aktive tatimore të shtyra 41
23 Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare 41
24 Detyrime ndaj klientëve 42
25 Huatë 42
26 Borxhi i varur 43
27 Detyrime të tjera 43
28 Provizione 43
29 Kapitali aksionar 44
30 Primi i kapitalit 44
31 Rezerva e përgjithshme 44
32 Analizë maturiteti për aktivet dhe detyrimet 45
33 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara 46
34 Shënime për palët e lidhura 48
35 Ngjarjet pas datës së bilancit 49
36 Administrimi i rrezikut financiar 49

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Banka Credins Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Credins Sh.a' (më tej referuar si"Banka" ose "Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2018 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.
Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
18 qershor 2019

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018[1]

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017
		Lek'000	Lek'000
Të ardhura nga interesat	3	8,935,503	8,747,753
Shpenzime për interesat	3	(2,090,784)	(1,854,250)
Të ardhura neto nga interesat	3	**6,844,719**	**6,893,503**
Të ardhura nga komisionet	4	941,562	843,150
Shpenzime për komisionet	4	(112,667)	(117,443)
Të ardhura neto nga komisionet	4	**828,895**	**725,707**
Shpenzime të tjera	5	(500,449)	(582,541)
Të ardhura të tjera	5	4,146,679	403,281
Fitimi nga kurset e këmbimit		(139,711)	77,815
Të ardhura të tjera bankare		**3,506,519**	**(101,445)**
Humbje nga zhvlerësimi i huave, neto	6	(5,208,830)	(2,307,234)
Humbje nga huatë e pambledhshme	16,17	(1,180,714)	(317,647)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	19	(293,710)	(269,895)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	20	(29,577)	(37,436)
Shpenzime personeli	7	(1,336,849)	(1,202,104)
Shpenzime të përgjithshme administrative	8	(2,435,012)	(2,040,621)
		(10,484,692)	**(6,174,937)**
Pjesa e humbjes së investimit me pjesmarrje	14	(11,909)	(5,300)
Fitimi para tatimit		**683,532**	**1,337,528**
Shpenzime tatimi mbi fitimin	9	(327,671)	(340,392)
Tatim fitimi i shtyrë	9	29,173	74,604
Fitimi neto i vitit		**385,034**	**1,071,740**

[1] Shënimet 1 deri 36 në faqe 5 deri ne 68 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018[2]

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017
		Lek '000	Lek '000
Fitimi neto i vitit		**385,034**	**1,071,740**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:			
Letrat me vlerë të investimit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë gjatë vitit	14	852,598	-
Efekti i tatim fitimit		(127,890)	-
Fitimet / (humbjet) neto të instrumenteve të borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		**724,708**	-
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	14	-	45,110
Efekti i tatim fitimit		-	(7,955)
Fitimet / (humbjet) neto nga aktivet financiare të vlefshme për shitje		-	37,155
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse neto për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:		**724,708**	**37,155**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit		**724,708**	**37,155**
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit mbi fitimin		**1,109,742**	**1,108,895**
Për:			
Aksionerët e Mëmës		1,108,703	1,110,938
Interesa jo-kontrollues		1,039	(2,043)
		1,109,742	**1,108,895**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins sh.a më 21 mars, 2019 and nënshkruar në emër të tij nga:

z. Maltin Korkuti
Drejtor i Përgjithshëm

znj. Valentina Prodani
Drejtore e Departamentit Financë Kontabilitet

[2]Shënimet 1 deri 36 në faqet 5 deri në 68 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2018[1]

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
		Lek '000	Lek '000
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10	33,222,241	30,964,607
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	11	12,214,431	11,352,440
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	12	242,300	194,606
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	13	1,085,425	450,720
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	14	43,796,570	29,322,957
Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje	15	27,999	15,950
Emri i mirë	15	43,371	43,371
Qira financiare	16	1,115,835	1,065,777
Hua dhe paradhënie për klientët	17	93,124,102	97,283,218
Te drejta tatimore korrente		19,080	-
Prona të riposeduara	18	5,106,821	4,764,175
Aktive afatgjata materiale	19	3,076,280	2,721,640
Aktive afatgjata jomateriale	20	107,426	106,138
Aktive të tjera	21	483,067	1,153,446
Të drejta tatimore të shtyra	22	44,092	142,808
Totali i aktiveve		**193,709,040**	**179,581,853**
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	23	4,068,161	6,099,386
Detyrime ndaj klientëve	24	167,253,446	151,053,971
Huatë	25	175,923	186,747
Detyrimet tatimore aktuale		-	209,590
Borxhi i varur	26	6,183,124	6,257,946
Detyrime të tjera	27	455,188	576,957
Provizione	28	58,844	6,875
Totali i detyrimeve		**178,194,686**	**164,391,472**
Kapitali			
Kapitali aksionar	29	8,505,811	8,083,240
Primi i aksioneve	30	3,143,693	3,112,906
Rezerva e përgjithshme	31	1,905,710	1,646,347
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	14	769,783	45,075
Fitime të pashpërndara		1,178,900	2,293,334
Totali i kapitalit aksionar		**15,503,897**	**15,180,902**
Interes jo-kontrollues		10,457	9,479
Totali i kapitalit aksionar		**15,514,354**	**15,190,381**
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		**193,709,040**	**179,581,853**

[1]Shënimet 1 deri 36 në faqet 5 deri në 68 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018[1]

	Kapitali aksionar	Primi i kapitalit	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali	Interesi jo kontrollues	Totali i kapitalit aksionar
	Lek'000	Lek'000	Lek'000	Lek'000	Lek'000	Lek'000	Lek'000	Lek'000
Gjendja më 1 janar 2017	7,307,701	2,892,166	1,446,025	769,783	1,178,900	13,594,575	7,920	13,602,495
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,073,240	1,073,240	-	1,073,240
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	37,155	37,155
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	1,073,240	1,073,240	37,155	1,110,395
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 28)	377,898	-	200,322	-	(578,220)	-	-	-
Emetim i aksioneve të reja	397,641	220,740	-	-	-	618,381	-	618,381
Interesa jokontrolluese si rrjedhojë e bashkimit	-	-	-	-	-	-	1,920	1,920
Gjendja më 31 dhjetor 2017	8,083,240	3,112,906	1,646,347	769,783	1,673,920	15,286,196	47,075	15,333,271
Impakti i implementimit të SNRF 9 Shënimi 2.5					(463,145)	(463,145)		(463,145)
Balanca Hapëse nën SNRF 9	8,083,240	3,112,906	1,646,347	769,783	1,210,775	14,823,051	47,075	14,870,126
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,830,189	1,830,189	-	1,830,189
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	383,995	383,995	724,708	1,108,703
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	2,214,184	2,214,184	724,708	2,938,892
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 28)	389,044	-	259,363	-	(648,407)	-	-	-
Emetimi aksioneve të reja	33,527	30,787	-	-	-	64,314	-	64,314
Pagimi i dividentëve	-	-	-	-	(389,044)	(389,044)	-	(389,044)
Humbja e kontrolit në një filial	-	-	-	-	2,167	2,167	(61)	2,106
Gjendja më 31 dhjetor 2018	8,505,811	3,143,693	1,905,710	769,783	1,178,900	15,503,897	10,457	15,514,354

[1]Shënimet 1 deri 36 në faqet 5 deri në 68 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018[1]

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017
		Lek '000	Lek '000
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		**683,532**	**1,337,528**
Rregullimet për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	19,20	323,287	307,329
Aktivet afatgjata të nxjerra jashtë përdorimi	19	93,219	162,287
Zhvlerësimi i huave ndaj klientëve	6	5,208,830	2,307,234
Humbje të tjera nga huatë e pambledhshme	16,17	(1,180,714)	(317,647)
Pjesa e humbjes të investimit me pjesmarrje		11,909	5,300
Zhvlerësimi i pronave të riposeduara	18	194,488	497,357
Të ardhurat neto nga interesat	3	(6,844,719)	(6,893,503)
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur		(205,387)	(176,661)
Flukset e mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapitalin e punues		**(1,715,555)**	**(2,770,776)**
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave	12	(20,426)	1,337,947
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve	17	(1,532,498)	(5,682,474)
Ndryshimi në qiranë financiare	16	(50,058)	(120,002)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën e Shqipërisë	11	(888,029)	168,211
Ndryshimi në pronat e riposeduara	18	(537,135)	(1,653,350)
Ndryshimi në aktive të tjera	21	669,258	191,220
Ndryshimi në detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	23	(2,099,060)	3,608,221
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	24	15,813,036	7,276,170
Ndryshimi në detyrime të tjera	27,28	(283,045)	470,055
Interesi i arkëtuar		10,596,792	8,569,061
Interesi i paguar		(1,720,897)	(1,827,053)
Tatim fitimi i paguar		(412,294)	(130,802)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		**17,820,089**	**9,436,428**
Aktivitetet investuese			
Blerje e letrave me vlerë	13,14	(28,345,383)	(20,514,205)
Shitje e letrave me vlerë	13,14	5,793,969	3,741,810
Letra me vlerë të maturuara	13,14	8,314,212	8,396,879
Investime ne filiale	15	(20,633)	(21,250)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	19	(743,015)	(677,058)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	20	(30,866)	(32,285)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		**(15,031,716)**	**(9,106,109)**
Aktivitetet financuese			
Flukse hyrëse nga borxhi i varur	26	548,091	1,936,920
Flukse dalëse të borxhit të varur	26	(413,540)	(948,519)
Pagesa të financimeve të reja	25	49,184	(13,101)
Emetim i kapitalit		(714,474)	618,381
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		**(530,739)**	**1,593,681**
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalente me to		**2,257,634**	**1,924,000**
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		30,964,607	29,040,607
Aktive monetare dhe ekuivalente me to, më 31 dhjetor		**33,222,241**	**30,964,607**

[1]Shënimet 1 deri 36 në faqet 5 deri në 68 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

1 Informacion i Përgjithshëm

Banka Credins SHA (këtej e tutje "Grupi" ose "Banka") është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri ne përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Grupi është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë" (këtej e tutje referuar si "Banka Qendrore").

Me 31 dhjetor 2018, Grupi ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të saj në Tiranë, 50 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozet, Kavajë, Lushnje, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 8 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 dhjetor 2017: 50 degë dhe 8 agjenci).

Aksionarët e Grupit kanë rënë dakord që Banka të blejë 76% të aksioneve me të drejtë vote të "CREDINS INVEST-sh.a-Shoqëri administruese e Fondeve te Pensionit dhe Sipermarrjeve te Investimeve Kolektive", me pare "Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit "SiCRED" SHA" që zotëronte "SICRED SHA", nëpërmjet marrëveshjes së blerjes së aksioneve firmosur më 22 dhjetor 2014, për një shumë prej 60,000 mijë Lekë. Aprovimi për ndryshimin e strukturës së aksionarëve dhe ndryshimi i kontrollit të "Shoqërisë Administruese e Fondit të Pensionit "SiCRED" SHA" është dhënë nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 28 prill 2015. Ky ndryshim është regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit më 10 qershor 2015, që është dhe data kur kontrolli mbi shoqërinë është bërë efektiv. Gjatë viteve, kapitali i ri shtesë është injektuar nga Grupi. Gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 Grupi nuk ka injektuar kapital të ri (31 dhjetor 2017: 6.080 mijë LEK).

Aksionerët e Grupit ranë dakord për blerjen nga Grupi të 95% të aksioneve të "Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG" sh.a. "për një shumë prej 3,325 mijë Lekë. Kjo është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 16 mars 2016. Me 20 prill 2018 pjesa e aksioneve zotëruar nga Grupi tek ALREG sh.a zbriti në 47.5% duke humbur kështu kontrollin në këtë shoqëri. Kapital shtesë është injektuar në vitin 2018 nga ana e Grupit në një vlerë prej 14,875 mijë LEK.

Aksionerët e Grupit ranë dakord për blerjen nga Grupi të 42.5% të aksioneve të "Bursa Shqiptare e Titujve ALSE" sh.a. "për një shumë prej 21,250 mijë lekësh. Kjo është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 28 korrik 2017.

Më 31 dhjetor 2018 Grupi kishte 883 punonjës (31 dhjetor 2017: 872 punonjës). Adresa e zyrave qendrore të Bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rruga "Vaso Pasha," Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

2 Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, të matura me vlerë të drejtë dhe pronave të riposeduara të matura me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në mijë LEK, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

2.1.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

2.1.2 Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

Grupi e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e raportimit (jo korrente) paraqitet në shënimin 32.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Grupit. Janë bërë disa riklasifikime nga viti kaluar për tu prezantuar më mirë me klasifikimin aktual.

2.1.3 Bazat për konsolidimin

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Mëmës dhe filialeve të saj më 31 dhjetor 2018. Kontrolli arrihet kur Mëma ekspozohet, ose i lind e drejta të përfitojë nga përfshirja e tij në filial, të ardhura të cilat mund të jenë të variushme, si dhe nëse ka aftësinë të afektojë këto rezultate nëpërmjet ndikimit të tij mbi filialin.

Specifikisht, Mëma kontrollon një filial, nëse dhe vetëm nëse, Mëma ka:

- Ndikim mbi filialin (p.sh: të drejta ekzistuese që i japin mundësinë të drejtojë aktivitetet kryesore të filialit)
- Ekspozim ose i lind e drejta e përftimit të rezultateve si rrjedhojë e përfshirjes së saj në filial
- Aftësinë për të ushtruar ndikimin e saj mbi filialin, për të ndikuar mbi rezultatet e ardhshme

2. Politikat Kontabël (vazhdim)

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara (vazhdim)

2.1.3 Bazat për konsolidimin (vazhdim)

Përgjithësisht, prezumohet që kush ka shumicën e të drejtave të votës, ushtron kontrollin. Për të mbështetur këtë supozim, si dhe në rastet kur Mëma nuk ka shumicën e të drejtës së votës mbi një filial, Mëma konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat për të vlerësuar nëse ka ndikim mbi filialin, të tillë si:

- Marrëveshjet kontraktuale me të tjerë aksionere që kanë të drejta vote në filial
- Të drejta të cilat vijnë nga marrëveshje të tjera kontraktuale
- Të drejtat e votës së Grupit si dhe të tjera të drejta vote të mundshme

Mëma rivlerëson fakin nëse ajo kontrollon ose jo një filial, në bazë të fakteve dhe rrethanave të cilat diktojnë që mund të ketë ndryshime në një ose më shumë elemente të kontrollit. Konsolidimi i filialeve fillon kur Mëma merr kontrollin dhe mbaron kur Mëma e humbet këtë kontroll mbi filialin. Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e filialit të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data që Mëma merr kontrollin deri në datën kur ajo e humbet ate.

Fitimi ose humbja dhe çdo element i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse i përkasin aksionerëve të mëmës si dhe interesave jo-kontrollues, edhe në rastin kur kjo sjell si pasojë një interes jo-kontrollues negativ. Në rastet që gjykohet e nevojshme, bëhen rregullime në pasqyrat financiare të filialeve për të sjellë politikat e tyre kontabël në linjë me politikat kontabël të përdorura nga Grupi. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, dhe aktivet, kapitali, te ardhurat dhe shpenzimet dhe flukset e parasë të lidhura me transaksione të ndodhura ndërmjet shoqërive të Grupit eleminohen plotësisht në konsolidim. Një ndryshim në interesin e zotëruar në një filial, që nuk sjell si pasojë humbjen e kontrollit, kontabilizohet si një transaksion me kapitalin.

Nëse Mëma humbet kontrollin mbi filialin, ai çregjistron të gjitha aktivet (duke përfshirë edhe emrin e mirë), detyrimet, interesin jo-kontrollues si dhe elementë të tjerë të kapitalit, duke njohur në fitim ose humbje cdo rezultat nga çregjistrimi. Çdo investim i mbajtur njihet me vlerë të drejtë.

2.1.3.1 Kombinimi i bizneseve dhe emri i mirë

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shumë e të gjithë vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes si dhe me vlerën e çdo interesi jo-kontrollues në shoqërinë e blerë. Për cdo kombinim biznesi, Grupi zgjedh nëse do ta masë interesin jo- kontrollues me vlerë të drejtë ose me pjesën proporcionale të tij në aktivet neto të identifikueshme të shoqërisë së blerë. Kostot e lidhura me blerjen përfshihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin dhe konkretisht në zërin shpenzime administrative.

Kur Grupi blen një biznes, ai vlerëson aktivet financiare dhe detyrimet financiare të marra, për klasifikimin e përshtatshëm si dhe alokimin në përputhje me termat kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe kushtet specifike në datën e blerjes. Çdo konsideratë e mundshme që do duhet të transferohet nga shoqëria blerëse, do të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Konsiderata e mundshme që klasifikohet si aktiv ose detyrim si instrument financiar, dhe sipas qëllimit te SNK 39 Instrumentat financiarë: Njohja dhe matja, matet me vlerë të drejtë, dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen ne pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Emri i mire matet fillimisht me kosto (që rezulton nga tejkalimi i konsideratës së dhënë dhe vlerës së njohur për interesin jo-kontrollues) si dhe ndonjë interes tjetër mbi aktivet neto të identifikueshme dhe detyrimet e marra. Nëse vlera e drejtë e aktiveve neto të blera tejkalon shumën totale të konsideratës së transferuar, Mëma ri-vlerëson nëse i ka identifikuar saktë të gjitha aktivet e blera dhe të gjitha detyrimet e marra, si dhe rishikon procedurat e përdorura për të vlerësuar shumat për tu njohur në datën e blerjes. Nëse rivlerësimi rezulton sërish në tejkalim të konsideratës së transferuar, atëherë fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Pas njohjes fillestare, emri i mirë matet me kosto duke i zbritur çdo zhvlerësim të akumuluar. Për qëllim të testimit të rënies së vlerës, emri i mirë i përftuar nga kombinimi i biznesit, i alokohet çdo njësie gjeneruese të parasë së Grupit, që priten të përfitojnë nga kombinimi, pavarësisht nëse aktive dhe detyrime të tjera të shoqërisë së blerë i janë alokuar atyre.

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël te Grupit, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

2.2.1 Parimi i vijimësisë

Grupi kryen rregullisht "stress test-e", për të testuar impaktin e mundshëm të indikatorëve makroekonomikë në pozicionin financiar, performancën dhe përputhshmërinë rregullatore. Këto "stress test-e" janë fokusuar kryesisht në impaktin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave të Grupit, pozicionit financiar duke përfshirë rrezikun e tregut. Gjatë këtij testimi përdoren modele zyrtare parashikuese të Grupit së Shqipërisë dhe vlerësime të brendshme të Grupit. Testet janë dinamike dhe kryhen për të vlerësuar efektin e mundshëm te ndikimit të rritjes/pakësimit të klientëve tek zërat e ndryshëm të pozicionit financiar, dhe të ardhurave dhe shpenzimeve, për një periudhë të caktuar kohore.

2. Politikat Kontabël (vazhdim)

2.2 Përdorimi I vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

2.2.1 Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Drejtimi i Grupit ka kryer një vlerësim të aftësisë së Grupit për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që Grupi ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë. Për informacionin shpjegues rreth mjaftueshmërisë së kapitalit referohuni në notën 36.6.

2.2.2 Humbjet nga zhvleresimi per aktivet financiare (Politikë e zbatuar pas datës 1 janar 2018)

Grupi konsideron ekspozimet si joperformues/te zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë nga rrethanat e meposhtme të cilat kane një ndikim përkeqësues në mjetet monetare të pritshme:

► Ditët në vonesë për një llogari më shumë se 120 dite (në rastin e Korporatave dhe biznesit të mesem (ME) 150),
► Kredia eshte e kategorizuar nga nje vleresim ne renie (kredi qe kane nje vleresim të barabarte me 7 ose nje vleresim ekonomik te barabarte me 10)
► Kredia është ne periudhe kurimi (3 muaj' periudhe)
► Kredia është subjekt i ndikimit (ose nga nje grup i klienteve të lidhur ne rastin e Korporates. Mikro dhe kredi te vogla (SE)

Perkufizimi i vonesës së permendur më sipër (zhvleresimit) përdoret në nivel llogarie (kredie) për klientet individe, ndërsa për klientet korporate përdoret në nivel klienti. Keshtu, nëse një llogari e një klienti korporate është në vonesë të gjitha llogarite e tij konsiderohen në vonesë.

Kredite të cilat nuk janë të testuara individualisht për zhvleresim vlerësohen kolektivisht. Në zhvleresimin kolektiv përfshihen gjithashtu edhe kredite mikro dhe konsumatore.

Zhvleresimi kolektiv llogaritet ne lidhje me stadin 2 dhe 1.

Stadi 2: Për llogaritë e testuara kolektivisht fondi i zhvleresimit eshte e njejte me Humbjet e Pritshme (ECL) të gjithe jetës (kohezgjatjes) së kredisë. ECL e gjithe jetes përcaktohet si humbja e të gjitha eventeve të mundshme përgjate gjithë jetës së një instrumenti financiar (p.sh, rreziku i daljes në vonese që ndodh në një instrument financiar gjatë jetës së pritshme të tij).

Stadi 1: Për llogaritë e testuara në grup (kolektiv) në Stadin 1, llogaritet ECL 12 mujore. 12-muaj ECLs është humbja qe pritet të materializohet ne 12 muajt ne vijim – kështu probabiliteti 12 mujor shumezohet me Ekzpozimin në Risk (EAD) aktuale dhe Humbja e Ndodhur (LGD) koresponduese. Ne rastet kur maturiteti i mbetur eshte me pak se 12 muaj, në vend të Propabilitetit të Dështimit (PD) 12 mujore përdoret PD e gjithe jetës.

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi si në SNRF 9 dhe SNK 39 në të gjitha kategoritë e aktiveve financiare të përfshira kërkon gjykimin, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga zhvlerësimi dhe vlerësimit të një rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë.
Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojë në nivele të ndryshme të zhvlerësimit. Llogaritjet ECL të Grupit janë rezultatet e modeleve komplekse me një numër supozimesh themelore të zgjedhura në inputet e ndryshueshme dhe ndërvarësîve të tyre. Elementet e modeleve ECL që konsiderohen gjykime dhe vlerësime kontabël përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Grupit, i cili cakton PD-të në nivelet individuale
- Kriteret e Grupit për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë dhe kështu që lejimet për aktivet financiare duhet të maten në bazë të Humbjeve të Pritshme Përgjatë Jetës (LTECL) dhe vlerësimi cilësor Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL-ja e tyre vlerësohet në baza kolektive
- Zhvillimi i modeleve ECL, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve
- Përcaktimi i lidhjeve midis skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, si dhe efektet në PD, EAD dhe LGD
- Përzgjedhja e skenarëve makroekonomikë të parashikuar nga pikëpamjet dhe koeficientet e tyre të probabilitetit, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet ECL

Ka qenë politika e Grupit për të rishikuar rregullisht modelet e saj në kontekstin e përvojës aktuale të humbjes dhe përshtatur kur është e nevojshme.

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

2. Politikat Kontabël (vazhdim)

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

2.2.3 Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare (Politikë e zbatuar para datës 1 janar 2018)

Grupi rishikon portofolet e tij të kredisë në baza mujore për të vlerësuar zhvleresimin. Ne përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Grupi ben gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë te vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol kredish para se rënia te mund të identifikohet me një kredi individuale në këtë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një bankë, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

Huatë të zhvlerësuara individualisht janë ato për të cilat ekziston një evidencë objektive zhvlerësimi si:

- Huatë me më shumë se 45 ditëvonesa;
- Huatë e ristrukturuara (duke përjashtuar huatë e ristrukturuara në kategorinë standarde dhe në ndjekje);
- Huatë e biznesit me vleresim B- dhe me poshtë;
- Huatë hipotekare me pike krediti 7 ose pa pikë;
- Huatë që kanë kolaterale të perbashkëta me huatë të zhvlerësuara individualisht.
- Huatë nga falimentimi i aktivitetit të huamarrësit.

Në llogaritjen e zhvlerësimit individual të huave merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm: Shuma e kredive sipas standardeve IFRS; koha e ekzekutimit; norma e interesit; kolateralet që garantojnë huatë; kostoja e ekzekutimit të kolateraleve.

Kreditë të cilat nuk janë testuar individualisht për zhvlerësim dhe kredi që janë testuar individualisht dhe kanë rezultuar pa zhvlerësim, vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim. Kreditë e vlerësuara kolektivisht për zhvlerësim janë ato që nuk tregojnë evidencë objektive të rënies, dhe ato që vlerësohen individualisht por nuk krijojnë dëmtime të konsoliduara. Në dëmtimin kolektiv përfshihen edhe kreditë mikro dhe individët, të cilët sigurohen nga matrica e tranzicionit.

Zhvlerësimi në grup llogaritet në bazë të probabilitetit të humbjes për cdo sektor ekonomik. Probabiliteti i humbjes rishikohet cdo dy vite. Për secilën degë të industrisë, koeficienti i pritshëm i humbjes llogaritet si shuma e ekspozimit të humbur dhe kredive të shlyera, të ndara me shumën historike të miratuar për çdo degë të industrisë.

2.2.4 Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje

Grupi shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Trajtimi i instrumentave financiare (obligacionet qeveritare dhe ekspozimet me bankat) eshte ndryshe nga trajtimi i pergjithshem në lidhje me percaktimin e parametrave. Ndërkohe që LGD vendoset thjesht ne 45% (sipas rregullave CRR), Probabiliteti i voneses (PD) lidhet me vlerësimin e shtetit specific sipas S&P.

Mqs nuk ka pasur perkeqesim të rëndësishëm në rrezikun e kredisë për vlerën e portofolit të letrave me vlerë është llogaritur vetem PD 12 mujore kumulative.

2.3. Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet

2.3.1 Standarde të reja dhe interpretime

Grupi aplikoi për herë të parë disa standarde dhe ndryshime, të cilat janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Grupi nuk ka miratuar më herët ndonjë standard, interpretim ose amendim tjetër që është lëshuar por nuk është ende efektiv.

Natyra dhe efekti i këtyre ndryshimeve janë dhënë më poshtë. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi të ri ose ndryshimi përshkruhet më poshtë:

SNRF 9 Infrimentat financiarë

SNRF 9 zevendeson SNK 39 për periudhat me ose pas 1 Janar 2018. Grupi ka zgjedhur si politike per të përdorur kontabilitetin mbrojtes sipas SNK 39, politike kjo e lejuar nga standarti SNRF 9. Grupi nuk i ka riparaqitur informacionin e pasqyrave te 2017 per instrumentat financiare subject i SNRF 9. Keshtu informacioni krahasues per 2017 eshte paraqitur sipas SNK 39 dhe nuk eshte I krahasueshem me informacionin e paraqitur per vitin 2018. Diferencat e rezultuara nga adoptimi i SNRF 9 janë njohur drejtëpërdrejtë në fitimet e pashperndara me 1 Janar 2018 dhe shpalosen në shënimin 2.5.

Ndryshime ne klasifikime dhe matje

Për të përcaktuar kategorine e klasifikimit dhe matjes SNRF 9 kerkon qe te gjitha aktivet financiare pervec instrumentave te kapitalit dhe derivativeve te vleresohen bazuar ne nje kombinim te modelit te biznesit te entitetit per manaxhimin e aktiveve dhe karakteristikave te flukseve monetare te instrumentave te kontraktuar.
Matja e kategorive te instrumentave nga sipas SNK 39 (me vlerë te drejtë përmes fitimit ose humbjes, te vlefshme për shitje, të mbajtura deri ne maturim dhe me kosto te amortizuar) është zevendesuar nga:

✓ Instrumenta borxhi me kosto te amortizuar

2. Politikat Kontabël (vazhdim)

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.3.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime (vazhdim)

- ***SNRF 9 Instrumentat financiarë (vazhdim)***

Ndryshime ne klasifikime dhe matje (vazhdim)

- ✓ Instrumenta borxhi me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëperfshirese, me fitimet ose humbjet te ricikluara ne fitim ose humbje kur crregjistrohen
- ✓ Instrumenta kapitali me vlere te drejte permes te ardhurave te tjera gjitheperfshirese, pa opsionin e riciklimit te fitimit ose humbjes në fitim ose humbje në crregjistrim.
- ✓ Aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Llogaritja e detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njejtë me atë të SNK 39, me përjashtim të rasteve të trajtimit të fitimeve ose humbjeve që lindin nga rreziku i kredisë të një subjekti që lidhet me detyrimet e përcaktuara në VDPFH. Lëvizje të tilla janë paraqitur në të ardhura gjithëpërfshirëse pa kryer asnjë riklasifikim të mëvonshëm në pasqyrën e të ardhurave.

Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë nuk janë më të ndarë nga një aktiv financiar bazë. Në vend të kësaj, aktivet financiare klasifikohen në bazë të modelit të biznesit dhe termave të tyre kontraktuale, siç shpjegohet në Shënimin 2.4.4.1.1 dhe 2.4.4.1.2. Llogaritja për derivativët e përfshirë në detyrimet financiare dhe në kontratat bazë jo-financiare nuk ka ndryshuar. Politikat kontabël të Grupit për derivativët e përfshirë janë përcaktuar në Shënimin 2.4.4.2.

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit është shpjeguar në Shënimet 2.4.2 dhe 2.4.4. Ndikimi sasior i zbatimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 është paraqitur në Shënimin 2.5.

Ndryshimet në llogaritjen e zhvlerësimit

Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht llogaritjen e Grupit për zhvlerësimin e humbjeve nga kreditë duke zëvendësuar metodën e humbjeve të hasura të SNK 39 me një qasje të pritshme të humbjes nga kredia (ECL). SNRF 9 kërkon që Grupi të regjistrojë një kompensim për ECL-të për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen me VDPFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Zbritja bazohet në ECL-të që lidhen me probabilitetin e mospagimit në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm nëse nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga fillimi. Nëse aktivi financiar plotëson përkufizimin e aktiveve financiare të provigjionuara ose në blerje ose që në origjinë (POCI), zbritja bazohet në ndryshimin e ECL-ve gjatë jetës së aktivit. Detajet e metodës së zhvlerësimit të Grupit jepen në Shënimin 2.4.6 Ndikimi sasior i zbatimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 është përcaktuar në Shënimin 2.5.

- ***SNRF 7R***

Për të pasqyruar ndryshimet midis SNRF 9 dhe SNK 39, SNRF 7 Instrumentet Financiare u publikua përditësimi i këtij standardi dhe Grupi e ka miratuar atë së bashku me SNRF 9 për vitin që fillon më 1 janar 2018. Ndryshimet përfshijnë:

• Bërjen publike të tranzicionit, siç tregohet në Shënimin 2.5.
• Informacionet e detajuara cilësore dhe sasiore në lidhje me llogaritjet ECL, të tilla si supozimet dhe inputet e përdorura, janë dhënë në shënimet përkatëse.

Grupi nuk ka rishikuar krahasimet për instrumentet financiare të trajtuara nga SNRF 9 dhe SNK 39. Informacioni krahasues për vitin 2017 është sipas SNK 39 dhe nuk mund të krahasohet me informacionin e paraqitur për vitin 2018 sipas SNRF 9. Ndryshimet që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 u njohën direkt në të fitimet e pashpërndara më 1 janar 2018 dhe janë paraqitur në Shënimin 2.5. Grupi përfundoi vlerësimet e mëposhtme bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistonin në datën e aplikimit fillestar më 1 janar 2018:

• Modelet e biznesit sipas të cilave Grupi ka mbajtur dhe menaxhuar aktivet e saj financiare;
• Nëse duhet të vazhdojë ose të anulojë emërtimet e mëparshme të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që maten me VDPFH
• Për detyrimet financiare që ajo vazhdon të përcaktojë si VDPFH, qoftë duke paraqitur ndikimin e ndryshimeve, rreziku i saj i kredisë në të ardhura gjithëpërfshirëse do të krijonte ose do ta rriste mospërputhjen kontabël në fitime a humbje
• Nëse duhet të zgjedhë të klasifikojë disa instrumente të kapitalit neto të cilat nuk mbahen për tregtim si të mbajtura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDTAGJ).

Rakordimet nga hapja deri në mbylljen e zbritjeve ECL janë paraqitur në Shënimet 10.1, 11.1, 12.1 dhe 14.1, 16.1 dhe 17.1.

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.3.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime (vazhdim)

- ***SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët***

SNRF 15 zëvendëson të gjitha kërkesat ekzistuese të të hyrave në SNRF (SNK 11 Kontratat e Ndërtimit, SNK 18 Të Ardhurat, IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Klientit, IFRIC 15 Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Paluajtshme, KIRFN 18 Transferet e Pasurive nga Konsumatorët dhe KIS 31 Të Hyrat - Shërbimet e Reklamimit) dhe zbatohet për të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët, me përjashtim të rasteve kur kontratat janë në objektin e standardeve të tjera, siç janë SNK 17 Qiradhënie (ose SNRF 16 Qira, një herë e aplikuar). Kërkesat e tij gjithashtu sigurojnë një model për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në dispozicion të disa aktiveve jofinanciare, duke përfshirë aktivet afatgjata materiale, ndërtesat dhe pajisjet dhe aktivet jo-materiale.

Standardi përshkruan parimet që një njësi ekonomike duhet të aplikojë për të matur dhe njohur të ardhurat. Parimi bazë është që një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat në një shumë që reflekton shumën të cilën njësia ekonomike pret ta ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve të dhëna për një klient.

SNRF 15 krijon një model me pesë hapa për të llogaritur të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët dhe kërkon që të ardhurat të njihen në një shumë që reflekton shumën që një njësi ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Standardi kërkon që njësitë ekonomike të ushtrojnë gjykimin, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante gjatë zbatimit të secilit hap të modelit në kontratat me klientët e tyre. Standardi gjithashtu specifikon mënyrën e llogaritjes së kostove shtesë për marrjen e një kontrate dhe kostot që lidhen drejtpërsëdrejti me përmbushjen e një kontrate. Udhëzimet për aplikim janë dhënë në SNRF 15 për të ndihmuar subjektet në zbatimin e kërkesave të tyre në disa marrëveshje të përbashkëta, duke përfshirë licencat e pronësisë intelektuale, garancitë, të drejtat e kthimit, konsideratat kryesore kundrejt agjentëve, opsionet për mallra ose shërbime shtesë dhe thyerje. Grupi nuk ndikohet nga ky standard.

- ***Prezantimi i te ardhurave neto nga interesi***

Me efekt qe nga 1 janar 2018 paragrafi 82(a) i SNK 1 kërkon që të ardhurat nga interesi të llogaritet duke përdorur metoden e interest efektiv dhe të paraqitet vecante në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo nënkupton qe të ardhurat nga interesi te llogaritura duke perdorur interesin efektiv duhet të diferencohet dhe prezantohen vecantë nga të ardhurat nga interesi të llogaritura duke perdorur metoda të tjera.

Grupi konsideron si një tregues kyc performance marzhin neto nga interesat; matja përfshin si interesin e llogaritur duke përdorur metoden e interesit efektiv ashtu edhe atë të llogaritur mbi baza kontraktuale mbi aktivet dhe detyrimet te matura me vlerë të drejte përmes fitimit ose humbjes përvec atyre të mbajtura për tregtim.

Grupi rrjedhimisht ka vendosur të përfshije një ze tjeter të quajtur "Të tjera të ardhura nga interesi" me qellim që të tregojë te gjithe te ardhurat nga interesi, dhe është ne konsistence me raportimin e saj te brendshem te marzhit neto nga interesi dhe siguron informacion te besueshem dhe te duhur per palet e interesuara. Grupi ka zgjedhur gjithashtu te prezantoje shpenzimet e interesit ne te njejten menyre si te ardhurat.

Keshtu ajo ndan shpenzimet e interesit nga detyrimet e matura me kosto te amortizuar nga shpenzimet e tjera te interesit. Kjo perfaqeson nje ndryshon ne politikat kontabel dhe 2017 eshte riparaqitur ne te njejten menyre. Politikat kontabel te Bankes ne lidhje me te ardhurat/shpenzimet dhe metodes se interesit efektiv jane paraqitur ne shenimet 2.4.7.1 dhe 2.4.7.2.

2.3.2 Standarde dhe interpretime të lëshuara dhe të padoptuara

- ***SNRF 16 Qiratë***

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhëniet, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qera, KIS-15 Qiratë Operative-Nxitjet dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të aseteve "me vlerë të ulët" (p.sh. kompjuterët personalë) dhe qiratë afatshkurtra (dmth. me qera me një afat kohor me qira prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (dmth. Detyrimin e qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivit bazë gjatë afatit të qirasë (p.sh. aktivin e së drejtës së përdorimit).

Qiramarrësit do tu kërkohet të njohin veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit për aktivin e të drejtës së përdorimit. Qiradhënësit gjithashtu do të kërkohen që të rimaxhin detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohin shumën e rimatjes së detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin e të drejtës së përdorimit.

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

2.4.6.8 Qiratë financiare ("leasing")

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4.6 Zhvlerësimi i instrumentave financiarë (Politikë e zbatueshme pas 1 janar 2019) (vazhdim)

2.4.6.8 Qiratë financiare ("leasing") (vazhdim)

Grupi si një qiramarrës
Qiratë që nuk transferojnë te Grupi në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Grupi si një qiradhënës
Qiratë ku Grupi transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Grupi paraqet në pasqyrën e pozicionit financiar shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara.

Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

2.4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

2.4.7.1 Metoda e interest efektiv

Nën të dy standartet SNRF 9 dhe 39, të ardhurat nga interesi rregjistrohen duke perdorur metoden e interesit efektiv per te gjitha aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, derivative e normave te interesit per te cilat aplikohet kontabiliteti mbrojtes dhe efekti i amortizimit/riciklimit te lidhur me kontabilitetin mbrojtes. Ngjashëm me aktivet financiare me interes, të klasifikuar si të vlefshme për shitje ose të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39, të ardhurat nga interesi në aktivet financiare me interes të matur në VDTAGJ sipas SNRF 9 gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e interest efektiv. Shpenzimet e interesit llogariten gjithashtu duke përdorur metodën e interest efektiv për të gjitha detyrimet financiare të mbajtura me koston e amortizuar. NEI është norma që saktësisht aktualizon arkëtimet e ardhshme në para nëpërmjet jetës së pritshme të aktivit ose pasivit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël bruto të aktivit financiar.

NEI (dhe për rrjedhojë, kostoja e amortizuar e aktivit financiar) llogaritet duke marrë parasysh kostot e transaksionit dhe çdo zbritje ose tarife për blerjen e aktivit financiar, si dhe tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e normës së interest efektiv. Grupi njeh të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, llogaritja e NEI gjithashtu merr parasysh efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme që mund të ngarkohen në faza të ndryshme të jetës së pritshme të aktivit financiar dhe karakteristikave të tjera të ciklit jetësor të produktit (përfshirë parapagimet, interesat dhe komisionet).

Nëse pritshmëritë e flukseve monetare të mjeteve financiare ose të detyrimeve me normë fikse rishikohen për shkaqe të tjera përveç rrezikut të kredisë, atëherë ndryshimet në flukset e ardhshme monetare kontraktuale zbriten në NEI origjinale me një rregullim pasojë në vlerën kontabël. Diferenca nga vlera e mbartur e mëparshme është e rezervuar si një rregullim pozitiv ose negativ në vlerën kontabël të aktivit ose pasivit financiar në bilanc me një rritje ose ulje korresponduese të të ardhurave / shpenzimeve të interesit të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për instrumentet financiare me normë të luhatshme, rivlerësimi periodik i flukseve të mjeteve monetare për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut ndryshon gjithashtu normën efektive të interesit, por kur instrumentet fillimisht njiheshin në një shumë të barabartë me principalin, duke rivlerësuar të ardhmen pagesat e interesit nuk ndikojnë ndjeshëm në vlerën kontabël neto të aktivit ose pasivit.

2.4.7.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat neto nga interesi përfshijnë të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit të llogaritura duke përdorur si metodën e interesit efektiv ashtu edhe metoda të tjera. Këto janë paraqitur veças në faqen e pasqyrës së të ardhurave për të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet e interesit për të siguruar informacion simetrik dhe të krahasueshëm. Në të ardhurat / shpenzimet e tij të interesit të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Të ardhura / shpenzime të tjera interesi përfshijnë interesin mbi aktivet / detyrimet financiare të matura në VDPFH, përveç atyre që mbahen për tregtim, duke përdorur normën e interesit kontraktual. Të ardhurat / shpenzimet nga interesi në të gjitha aktivet / detyrimet financiare tregtare njihen si pjesë e ndryshimit të vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Grupi llogarit të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare, përveç atyre që konsiderohen si të dëmtuara nga kredia, duke aplikuar NEI në vlerën kontabël bruto të aktivit financiar.
Kur një aktiv financiar bëhet i zhvlerësuar (dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Stadi 3', Grupi llogarit të ardhurat nga interesi duke aplikuar NEI në koston e amortizuar neto të aktivit financiar. me zhvlerësim, Grupi kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve (vazhdim)

2.4.7.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit (vazhdim)

Për aktivet financiare të zhvlerësuara në blerje ose në origjinë (POCI) Grupi llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI-të rregulluar për zhvlerësimin dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të aktivit financiar. NEI i rregulluar nga kreditë është norma e interesit që, në njohjen fillestare, zvogëlon flukset monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar te aktivit financiar të POCI.

Grupi mban gjithashtu investime në aktivet financiare të emetuara në vende me norma interesi negative. Grupi zbulon interesin e marrë mbi këto aktive financiare si shpenzim interesi. Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike të rjedhin në Grup dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret specifike të mëposhtme të njohjes duhet gjithashtu të plotësohen para se të njihen të ardhurat.

2.4.8 Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Grupi fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e larmishme e shërbimeve financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një shumë që reflekton shumën për të cilën Grupi pret që të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.
Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet.
Shpenzime të tjera për tarifat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

2.4.9 Të ardhura neto tregtare

Të ardhura neto tregtare përfshijnë fitime dhe humbje në vlerën e drejtë dhe shpenzimet dhe të ardhurat e lidhura dhe dividentët, per aktivet dhe detyrimet financiare të mbajtura për tregtim. Këto janë përfshirë në zërin e të ardhurave nga interesi si të ardhura neto tregtare.

2.4.10 Humbja neto mbi aktivet dhe detyrimet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Humbja neto e instrumenteve financiare me VDPFH përfaqëson derivativë jo-tregtarë të mbajtur për qëllime të administrimit të rrezikut të përdorura në marrëdhëniet e mbrojtjes ekonomike, por që nuk kualifikohen për marrëdhëniet e kontabilitetit mbrojtës, aktivet financiare dhe detyrimet financiare të përcaktuara si në VDPFH dhe nga 1 janari 2018, gjithashtu aktivet jo-tregtare të matur në VDPFH, siç kërkohet ose zgjidhet sipas SNRF 9. Elementi i linjës përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë, interesin, dividentët dhe diferencat e këmbimit valutor.

2.4.11 Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.4.12 Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si letra me vlerë nëpërmjet të ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse ose letra me vlerë nëpërmjet fitimit ose humbjes (e detyrueshme).

2.4.13 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit.

(i) Njohja dhe matja (vazhdim)

Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e pjeseve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne te ardhmen Grupi do të këtë përfitime ekonomike nga këto pjese dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4.13 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar te aktivit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit
Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike	25%
Automjete	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%

2.4.14 Aktivet jomateriale

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike te blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mevonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimit njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) Licensat

Licencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Grupi janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike te ardhshme te trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

2.4.15 Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësia gjeneruese e mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese të mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë kryesisht të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen si fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

2.4.16 Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

2.4.17 Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Grupi paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Grupi njeh si detyrim shumën e përllogaritur të kostos për lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve te punëmarrësit për periudhën.

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4.17 Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Grupi gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

(iv) Kontribut vullnetar i pensionit për punonjësit

Grupi ka krijuar një Plan Pensioni Profesional për punonjesit e vetë. Bank merr përsipër të paguajë kontribute për cdo punonjës që ka firmosur një kontratë individuale për "Planin Profesional të Pensionit." Shpenzimi vjetor përfaqëson kontributin vjetor të paguar nga Grupi, dhe regjistrohet në zërin "Shpenzime Personeli," duke prekur pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Grupit, dhe pa ndikuar në detyrimet e mëvonshme të Grupit.

2.4.18 Provizione për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Grupi ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Grupi nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit me kontratën. Para se të njihet provizioni, Grupi njeh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

2.4.19 Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të perdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijonë nga mënyra në të cilën Grupi pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejtë në kapital, përkatësisht.

2. Politikat kontabel (vazhdim)

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4.20 Prona të riposeduara

Politika e Grupit është të përcaktoje nëse një aktiv i riposeduar do të përdoret për përdorim të brendshëm nga Grupi apo do të shitet. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për aktivitetet e brendshme të Grupit transferohen ne klasën perkatese të aktiveve me vlerën më të ulët mes vlerës së riposedimit dhe vlerës kontabël të aktivit fillestar të siguruar.

Grupi zotëron disa prona të riposeduara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve. Grupi i mat keto aktive te riposeduara fillimisht me kosto (çmim blerje). Në fund të cdo periudhe raportuese këto aktive maten me më të voglën mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën neto te realizueshme te pronave te riposeduara njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën lindin. Keto active çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivit) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

2.4.21 Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Grupit. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv te ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Grupit.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Grupi zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuara (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetes së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

2.4.22 Dividentët

Dividendët e aksioneve të zakonshme janë njohur si një detyrim dhe janë zbritur nga kapitali në momentin kur ata janë miratuar nga aksionarët e Grupit. Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018, Grupi ka deklaruar dividentë në vlerën prej 389,044 mijë lekë per tu paguar aksionareve të saj.

2.4.23 Rezervat e kapitalit

Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë "Rezervën e përgjithshme" që përfshin ndryshimet e bëra për rezervën ligjore siç përcaktohet në Ligjin e Grupit Qendrore dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri dhe "Rezervën e rivlerësimit" e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit.

2.5 Shpjegime tranzitore

Faqet në vijim prezantojnë ndikimin e adoptimit te SNRF IFRS 9 në pasqyrën e pozicionit financiar, dhe fitimeve të mbartura duke përfshirë efektin e zëvendësimit të SNK 39 të llogaritjeve të humbjes se ndodhur të kreditit me humbjen e pritshme të kreditit sipas SNRF 9. Tabela më poshtë rakordon provigjonet e krejiuara sipas SNK 39 ose SNK 37 më 31 dhjetor 2017 më humbjet e pritshme të kreditit sipas SNRF 9 me 1 janar 2018.

	31 dhjetor 2017	Ndikimi nga adoptimi për herë të parë	1 janar 2018
Provigjone për:	**Sipas SNK 39/SNK37**	**Ri-matja**	**Sipas SNRF 9**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (H&A sipas SNK 39 dhe KA sipas SNRF 9)	-	18,983	18,983
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore (H&A sipas SNK 39 dhe KA sipas SNRF 9)	-	9,461	9,461
Hua dhe paradhënie dhënë bankave (H&A sipas SNK 39 dhe KA sipas SNRF 9)	-	-	-
Letra me vlerë të mbajtura për shitje sipas SNK 39/ active financiare me VDPAGJ sipas SNRF 9	-	136,812	136,812
Qira financiare (H&A sipas SNK 39 dhe KA sipas SNRF 9)	77,785	37,624	115,409
Hua dhe paradhënie klientëve (H&A sipas SNK 39 dhe KA sipas SNRF 9)	16,049,578	229,242	16,278,820
Garanci financiare	-	25,109	25,109
Letër kredi për klientët	-	5,914	5,914
Totali	**16,127,363**	**463,145**	**16,590,508**

2. **Politikat Kontabël (vazhdim)**

2.5 **Shpjegime tranzitore (vazhdim)**

	31 dhjetor 17		Ndikimi nga adoptimi për herë të parë i SNRF 9		1 janar 18	
	Matja sipas SNK 39			Matja me humbjen e pritshme	Matja sipas SNRF 9	
Aktivet financiare	**Kategoria**	**Vlera**	**Riklasifikimi**		**Vlera e re e mbartur**	**Kategoria**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	L&R[1]	30,964,607	-	(18,983)	30,945,624	AC[2]
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	L&R	11,352,440	-	(9,461)	11,342,979	AC
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	L&R	194,606	-	-	194,606	AC
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	FVPL	450,720	-	-	450,720	FVPL (mandatory)
Letra me vlerë me VDPATGJ[3]		N/A	29,322,957	(136,812)	29,186,145	FVOCI
Nga: Letra me vlerë të mbajtura për shitje			*29,322,957*			
Letra me vlerë te mbajtura për shitje		29,322,957	(29,322,957)		N/A	
Në: Letra me vlerë të mbajtura për me VDPATGJ			*(29,322,957)*			
Qira financiare neto	L&R	1,065,777	*n/a*	(37,624)	1,028,153	
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	L&R	97,283,218	-	(229,242)	97,053,976	AC
Totali i aktiveve		**170,634,325**	-	**(432,122)**	**170,202,203**	-
Detyrimet						
Detyrimet ndaj bankave	AC	6,099,386	-	-	6,099,386	AC
Detyrime ndaj klientëve	AC	151,053,971	-	-	151,053,971	AC
Huatë	AC	186,747	-	-	186,747	AC
Borxhi i varur	AC	6,257,946	-	-	6,257,946	AC
Detyrime jo financiare						
Detyrime të tjera (Provigjone për zërat jashtë bilanci)	AC	576,957	-	(31,023)	545,934	AC
Totali i detyrimeve	-	**164,175,007**	-	**(31,023)**	**164,143,984**	-
Fitime të pashpërndara	-	**2,293,334**	-	**(463,145)**	**1,830,189**	-

3. **Net Interest income**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	7,538,835	7,770,862
Të ardhura neto tregtare	72,056	-
Letra me vlere të vlefshme për shitje	1,143,002	829,307
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	117,479	71,689
Hua dhënë bankave	19,287	25,157
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	44,844	50,738
Totali i të ardhurave nga interesat	***8,935,503***	***8,747,753***
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj bankave	(119,803)	(106,322)
Detyrime ndaj klientëve	(1,512,771)	(1,285,722)
Borxhi i varur	(418,264)	(453,996)
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	(39,946)	(8,210)
Totali i shpenzimeve për interesat	***(2,090,784)***	***(1,854,250)***
Të ardhura nga interesat,neto	**6,844,719**	**6,893,503**

[1] H&A – Hua dhe të arkëtueshme
[2] KA – Kosto e amortizuar
[3] VDPAGJ – Me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

4 **Të ardhura neto nga komisionet**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	907,209	799,366
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	34,353	43,784
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	***941,562***	***843,150***
Shpenzime për tarifa dhe komisione		
Tarifa për veprime ndërbankare	(46,336)	(38,385)
Veprime me thesarin	(38,609)	(42,516)
Të tjera	(27,722)	(36,542)
Totali i shpenzimeve për tarifa dhe komisione	***(112,667)***	***(117,443)***
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**828,895**	**725,707**

5 **Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera		
Rimarrje nga huatë e fshira	4,094,205	294,271
Të ardhura te tjera	52,474	93,407
Totali i të ardhurave të tjera	***4,146,679***	***387,678***
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet bankare	(500,449)	(566,938)
Totali i shpenzimeve të tjera	***(500,449)***	***(566,938)***
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	**3,646,230**	**(179,260)**

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përfshijnë shpenzime që lidhen me aktivitetet bankare, me rënien në vlerë të pronave te riposeduara, shpenzim i cili më 31 dhjetor 2018 eshte në shumën 194,488 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 497,356 mijë Lekë) (shënimi 18).

6 **Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Zhvlerësimi (ECL) për mjetet monetare dhe te ngjashme me to	10	(1,446)	-
Zhvlerësimi (ECL) shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	11	728	-
Zhvlerësimi (ECL) në hua dhe paradhenie klienteve	12	106	-
Zhvleresimi (ECL) në letrat me vlere	14	(6,479)	-
Zhvlerësimi (ECL) hua dhe paradhënie klienteve dhe qira financiare	16; 17	5,192,967	-
Zhvlerësimi ne hua dhe paradhënie klienteve dhe qira financiare	16; 17	-	2,307,234
Zhvlerësimi (ECL) ne te tjera aktive (debitoret)	21	2,008	-
Zhvlerësimi (ECL) ne garancite dhe letrat e kreditit	33	20,946	-
		5,208,830	**2,307,234**

7 **Shpenzime Personeli**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Pagat e punonjësve	943,776	851,693
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	128,316	113,764
Bonus dhe shpërblime	84,473	81,915
Primi i sigurimit të jetës për punonjësit	17,537	16,142
Të tjera	162,747	138,590
	1,336,849	**1,202,104**

8 Shpenzime Administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Sigurime dhe mbikëqyrje	611,105	505,423
Tarifa për palë të treta	558,865	473,866
Qira	441,682	441,476
Marketing dhe abonime	346,519	213,086
Mirëmbajtje	186,199	163,999
Ujë, energji	107,678	55,004
Pajisje	61,216	54,880
Të tjera	54,508	58,891
Taksa lokale dhe të tjera	34,011	41,552
Transport dhe udhëtime	33,229	32,444
	2,435,012	**2,040,621**

Sigurimi dhe mbikqyrja, tarifa për palë të treta si dhe për mirembajtjen janë rritur si rezultat i rritjes së aktivitetit të Grupit. Shpenzimet e marketingut janë rritur si rezultat i luhatjeve në këto tip shpenzimesh. Gjithashtu ka patur rritje në numrin e kartave Visa Cards dhe Master Cards të lëshuara dhe numrit të transaksioneve të kryera nëpërmjet pikave të ATM-ve dhe POS-eve.

9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Tatimi aktual	327,671	340,392
Tatim fitimi i shtyre (shënimi 22)	(29,173)	(74,604)
Tatimi mbi fitimin	**298,498**	**265,788**

Shpenzimet e zhvlerësimit të njohura nga Grupi në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm dhe të mos tejkalojnë limitet e përcaktuara nga Banka Qendrore. Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për 2018 dhe 2017 është 15%. Tatim fitimi i shtyrë është llogaritur mbi vlerën e letrave me vlerë të mbajtura për shitje dhe pronave të riposeduara. (Shënimi 22). Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	683,532	1,337,528
Tatim fitim i llogaritur si 15%	102,530	200,629
Adjustment for unrecognized loss of associate	1,786	795
Tatim i fitimit mbi humbjet e pazbritshme të shoqërive të kontrolluara	(649)	1,167
Efekti tatim fitimit mbi shpenzimet e pazbritshme	224,004	137,801
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	**327,671**	**340,392**

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritetet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen nga autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura përfshijnë humbje nga kreditë e pambledhshme, rënie vlere të pronave të riposeduara, provigjonet e krijuara, shpenzimin e amortizimit për përmiresimet e ambjenteve me qera të cilat nuk njihen per efekte fiskale, dhe shpenzime të tjera të panjohura sipas legjislacionit fiskal në fuqi. Grupi eshte audituar nga autoritetet fiskale deri 2015 per efekt tatim fitimi.

10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogarite rrjedhëse me bankat	3,427,096	2,662,593
Zhvlerësimi HPK[1] për llogaritë me bankat	*(212)*	-
Vendosjet në tregun e parasë	5,530,808	6,033,303
Zhvlerësimi HPK për vendosjet në banka	*(195)*	-
Aktive monetare në arkë	4,865,047	3,859,274
Llogarite rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	20,553,725	19,315,361
Zhvlerësimi HPK për balancat me with Bankën Qendrore	*(17,130)*	-
Në tranzit	(1,136,898)	(905,924)
	33,222,241	**30,964,607**

[1] HPK – Humbjes se pritshme te kreditit

10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to (vazhdim)

10.1 Zhvlerësimi për mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

				31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali	Totali
Gjendja më 1.1.2018	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Gjendja më 1 Janar SNRF 9	18,983	-	-	18,983	-
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-		-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	(1,446)	-	-	(1,446)	-
Çregjistrimi I aktiveve financiare	-	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-	-
Ndryshime ne vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31.12.2018	**17,537**	**-**	**-**	**17,537**	**-**

Vendosjet në tregun e parasë përfshijnë vendosjet me bankat rezidente dhe jo-rezidente, me maturitet afatshkurtër, deri në 3 muaj. Mjetet monetare në tranzit përfaqësojnë pagesa ndaj Autoriteteve Tatimore të kryera nga klientë të Grupit, për të cilat Grupi vepron si agjent për mbledhjen e tyre. Këto transaksione janë kryer brenda datës 31 dhjetor 2018, dhe mbyllen me transferimin e vlerave tek llogaria rrjedhëse e Grupit me Bankën Qëndrore në ditët e para të vitit 2019.Detajet mbi kompensimin për zhvlerësim të llogarive me Bankën Qendrore jepen në shënimin 11.1.

11 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore lidhur me rezervën e depozitave, Grupi duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Bankën Qendrore si një llogari rezervë. Bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 29 datë 16.05.2012 Grupi mund të përdorë rezervën e kërkuar në lekë nëse bilanci mesatar i fundvitit në llogarinë e rezervës 2017 gjatë periudhës së mbajtjes nuk është më i vogël se shuma e përcaktuar për rezervën e kërkuar. Maturimi i rezervës së detyrueshme llogaritet në baza mujore dhe rezerva në lekë është 70% e normës REPO njëvjeçare (norma bazë) në Shqipëri, e cila më 31 dhjetor 2018 ishte 1.00% (31 dhjetor 2017: 1.25%). Rezerva e shprehur në euro përfaqëson një normë interesi që është e barabartë me normën e depozitave të shpallur nga Banka Qendrore Evropiane e cila më 31 dhjetor 2018 ishte -0.4% (31 dhjetor 2017: -0.4%). Rezerva e shprehur në dollarë amerikane nuk ka interes. Më 31 dhjetor 2018, bilanci i parave të gatshme të kufizuara është 12,214,431 mijë lekë (31 dhjetor 2017: 11,352,440 mijë lekë).

11 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore (vazhdim)

11.1 Zhvlerësimi për shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	12,224,620	11,352,440
Zhvlerësimi HPK	*(10,189)*	-
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore, neto	**12,214,431**	**11,352,440**

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	31 dhjetor 2018 Totali	31 dhjetor 2017 Totali
Gjendja më 1.1.2018	-	-	-	-	-
Gjendja më 1 Janar SNRF 9	9,461	-	-	9,461	-
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-		-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	728	-	-	728	-
Çrregjistrimi i aktiveve financiare	-	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31.12.2018	**10,189**	**-**	**-**	**10,189**	**-**

12 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Bankat dhe institucione e tjera financiare jo-rezidente	**32,425**	**116,537**
Në monedhë të huaj	32,425	116,537
Bankat dhe institucionet e tjera financiare rezidente	**209,981**	**78,069**
Në lekë	66,870	57,997
Në monedhë të huaj	143,111	20,072
Totali, bruto	**242,406**	**194,606**
Zhvlerësimi HPK	*(106)*	-
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare, neto	**242,300**	**194,606**

Banka Credins sh.a.
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në mijë Lekë, pervec kur është shprehur ndryshe)

12 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare (vazhdim)

12.1 Zhvlerësimi për hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	31 dhjetor 2018 Totali	31 dhjetor 2017 Totali
Me risk të ulet	242,406	-	-	242,406	194,606
Zhvlerësimi HPK	*(106)*	-	-	*(106)*	-
Vlera e mbartur	**242,300**	**-**	**-**	**242,300**	**194,606**

	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	31 dhjetor 2018 Totali	31 dhjetor 2017 Totali
Gjendja më 1.1.2018	-	-	-	-	-
Gjendja më 1 Janar SNRF 9	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-	-
Kalim në Stadin **3** (nga 1 ose 2)	-	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-		-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	106	-	-	106	-
Çrregjistrimi I aktiveve financiare	-	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31.12.2018	**106**	**-**	**-**	**106**	**-**

13 Letra me vlerë me VDPFH (të mbajtura për tregtim)

Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për tregtim më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Bono thesari	49,925	76,393
Obligacione qeveritare	1,035,500	289,336
Derivate – Opsione shitje	-	84,991
Totali	**1,085,425**	**450,720**

Bono Thesari

Normat efektive të interesit për bonot e thesarit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 kanë qenë 2.6%. Detajet e bonove të thesarit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, duke treguar maturimin e tyre fillestar, vlerën e tyre kontabël dhe vlerën e drejtë përkatëse ne datën e raportimit, sipas llojit janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2018					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
12 muaj	50,000	(1,264)	1,087	49,823	102	49,925
	50,000	**(1,264)**	**1,087**	**49,823**	**102**	**49,925**

13 Letra me vlerë me VDPFH (të mbajtura për tregtim) (vazhdim)

Bono thesari (vazhdim)

	31 dhjetor 2017					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
12 muaj	78,000	(2,008)	292	76,284	109	76,393
	78,000	**(2,008)**	**292**	**76,284**	**109**	**76,393**

Obligacione qeveritare

Më 31 dhjetor 2018, Grupi kishte një portofol të obligacioneve qeveritare 5-vjeçare dhe 10-vjeçare, të shprehura në monedhën vendase (LEK). Interesi merret gjysëmvjetor në një norme kuponi respektive prej 5.45% (5-vjeçare) dhe 5.45% në 8.93% (10-vjeçare). Detajet e obligacioneve qeveritare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, duke treguar maturimin e tyre fillestar, vlerën e tyre të librave dhe vlerën e drejtë përkatëse në datën e raportimit, sipas llojit, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018						
	Vlera nominale	*Primi*	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
60 muaj	964,427	45,740	-	21,325	-	-	1,031,492
120 muaj	3,497	457	-	54	-	-	4,008
	967,924	**46,197**	**-**	**21,379**	**-**	**-**	**1,035,500**

	31 dhjetor 2017						
	Vlera nominale	*Primi*	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
60 muaj	99,000	-	-	794	-	-	99,794
120 muaj	183,755	-	-	5,787	-	-	189,542
	282,755	**-**	**-**	**6,581**	**-**	**-**	**289,336**

Derivative - Opsione shitje

Gjate viti 2017 Grupi bleu opsione shitje te lidhura me dy obligacione qeveritare. Opsionet jane ushtruar ne tetor 2018 dhe gjendja e tyre me 31 dhjetor 2018 eshte 0. Detaje te opsioneve me for 31 dhjetor 2017 jepen si me poshte:

	31 dhjetor 2017					
	Vlera nominale	*Monedha*	*Opsion Shitje*	*Norma e Kuponit*	*Data e lëshimit*	*Frekuenca e kuponeve*
60 muaj	2,133,120	USD	41,596	2.25%	25-Nov-16	6month
120 muaj	2,552,640	EUR	43,395	0.50%	15-Aug-17	12month
	4,685,760		**84,991**			

14 Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2018 and letrat me vlerë të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2017 paraqiten si si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	**31 dhjetor 2017**
Bono thesari	7,801,870	-
Obligacione qeveritare	36,125,033	-
Totali, bruto	**43,926,903**	**-**
Zhvlerësimi HPK	*(130,333)*	-
Totali, neto	**43,796,570**	**-**

	31 dhjetor 2018	**31 dhjetor 2017**
Bono thesari	-	6,473,516
Obligacione qeveritare	-	22,849,441
Totali		**29,322,957**

14 Letra me vlerë të investimit (vazhdim)

Bono thesari

Normat e interesit për bonot e thesarit të vlefshme për shitje gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 variuan nga 1.26% dhe 3.11% p.a (31 dhjetor 2017: 1.58% dhe 311% p.a). Detaje të bonove të thesarit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, lidhur me maturitetin e tyre fillestar, vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë në datën e raportimit, te klasifikuar sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2018					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
12 muaj	7,859,400	(148,518)	74,148	7,785,030	16,840	7,801,870
	7,859,400	**(148,518)**	**74,148**	**7,785,030**	**16,840**	**7,801,870**

	31 dhjetor 2017					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
12 muaj	6,543,060	(140,105)	67,840	6,470,795	2,721	6,473,516
	6,543,060	**(140,105)**	**67,840**	**6,470,795**	**2,721**	**6,473,516**

Obligacione qeveritare

Më 31 dhjetor 2018, Grupi kishte një portofol të obligacioneve qeveritare 2-vjeçare, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare, të shprehura në monedhën vendase (LEK). Interesi merret gjysëmvjetor me një normë kuponi përkatëse prej 0.75% në 3.35% (2-vjeçare), 2.70% në 5.00% (3-vjeçare), 4.14% në 6.45% (5 vjet), 4.89% në 10.85% (7-vjeçare) dhe 0,25% deri 9,25% (10-vjeçare), (31 dhjetor 2017: 1.50% në 3.35% (2-vjeçare), 2.70% ne 5.79% (3-vjeçare), 4.23% në 7.70% (5 vjet), 4.79% në 10.85% (7-vjeçare) dhe 5,16% deri 9,25% (10-vjeçare)). Detajet e obligacioneve qeveritare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, duke treguar maturimin e tyre fillestar, vlerën e tyre të librit dhe vlerën e drejtë përkatëse në datën e raportimit, sipas llojit, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018						
	Vlera nominale	*Primi*	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
24 muaj	1,266,776	54	(2)	6,974	1,273,802	14,352	1,288,154
36 muaj	190,600	4	-	2,979	193,583	1,353	194,936
60 muaj	6,357,050	65,500	-	45,778	6,468,328	173,043	6,641,371
64 muaj	3,394,050	-	(3,396)	-	3,390,654	(4,058)	3,386,596
84 muaj	5,461,600	111,623	(1,369)	58,306	5,630,160	248,849	5,879,009
120muaj	17,952,952	365,037	(179,876)	140,350	18,278,463	456,504	18,734,967
	34,623,028	**542,218**	**(184,643)**	**254,387**	**35,234,990**	**890,043**	**36,125,033**

	31 dhjetor 2017						
	Vlera nominale	*Primi*	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
24 muaj	2,347,445	-	(21)	5,860	2,353,284	606	2,353,890
36 muaj	693,100	269	-	12,714	706,082	8,378	714,460
60 muaj	3,610,900	24,739	-	57,943	3,693,582	52,776	3,746,358
84 muaj	4,343,600	171,570	(762)	53,907	4,568,315	(36,108)	4,532,207
120 muaj	11,000,209	418,178	(67,070)	126,550	11,562,859	24,657	11,502,526
	21,995,254	**614,756**	**(67,853)**	**256,974**	**22,884,122**	**50,309**	**22,849,441**

14 Letra me vlerë të investimit (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet letrat me vlerë të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse sipas riskut të kreditit, bazuar në sistemin e brendshëm të vlerësimit të Grupit dhe klasifikimit të stadit në fund të vitit

				31 dhjetor 2018
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Grada vlerësimit të brëndshëm				
AAA	21,039,622	-	-	21,039,622
AA+ deri AA-	-	-	-	-
A+ to A-	-	-	-	-
BBB+ deri BBB-	-	-	-	-
Më pak se BBB-	22,887,281	-	-	22,887,281
Të pa vlerësuara	-	-	-	-
Ekspozimi para zhvlerësimit	**43,926,903**	**-**	**-**	**43,926,903**
Zhvlerësimi	(130,333)	-	-	(130,333)
Vlera e mbetur	**43,796,570**	**-**	**-**	**43,796,570**

14.1 Zhvlerësimi për letrat me vlerë të investimit

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe të humbjeve të pritshme paraqitet si më poshtë:

				31 dhjetor 2018
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjëndja më 1 Janar SNRF 9	**29,322,957**	**-**	**-**	**29,322,957**
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	28,853,238	-	-	28,853,238
Çrregjistrimi I aktiveve financiare	(15,154,920)	-	-	(15,154,920)
Ndryshimi ne vleren e drejte	905,628	-	-	905,628
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjëndja më 31.12.2018	**43,926,903**	**-**	**-**	**43,926,903**

				31 dhjetor 2018
	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	Totali
Gjëndja më 1 Janar SNRF 9 (shenimi 2.5)	**136,812**	**-**	**-**	**136,812**
Kalim në Stadin 1 (nga 2 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 2 (nga 1 ose 3)	-	-	-	-
Kalim në Stadin 3 (nga 1 ose 2)	-	-	-	-
Rimatja neto e humbjes	-	-	-	-
Aktive financiare të blera ose të origjinuara	56,439	-	-	56,439
Çrregjistrimi I aktiveve financiare	(62,918)	-	-	(62,918)
Ndryshimi ne vleren e drejte	-	-	-	-
Të nxjerra jashtë bilanci	-	-	-	-
Ndryshime ne modelin, parametrat e riskut	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi këmbimit	-	-	-	-
Ndryshime në vlerën aktuale të zhvlerësimit	-	-	-	-
Gjëndja më 31.12.2018	**130,333**	**-**	**-**	**130,333**

15 Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje

Aksionerët e Bankes kanë pranuar që Grupi do të blejë 76% të aksioneve të "CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarrjes së Investimeve Kolektive ("Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit" SiCRED "sh.a.") nga "SICRED sh.a." nëpërmjet një marrëveshje blerjeje aksionesh të nënshkruar më 22 dhjetor 2014 për një shumë prej 60,206 mijë Lek. Emri i mirë që rezultoi nga kjo blerje arriti në shumën 43,371 mijë lekë. Gjatë viteve Banka ka injektuar kapital të ri të mëtejshëm në "Credins Invest". Gjatë vitit 2018 nuk është injektuar asnjë kapital shtesë (2017: 6,080 mijë Lekë).

15 Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje (vazhdim)

